



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 21 SHKURT 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 21. FEBRUARA 2013. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR  
2013**

### **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për debat parlamentar lidhur me mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për pagat e punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj,
4. Njoftimi i Grupit Parlamentar “6+” lidhur me marrëveshjen për ndërrimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, si dhe kërkesat e disa deputetëve nga komunitetet tjera joshumicë për zëvendësimin e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit nga radha e tyre.

### **Dnevni red**

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Zahtev Parlamentarne grupe Demokratskog saveza Kosova za parlamentarnu debatu u vezi sa neizvršenjem Odluke Ustavnog suda Republike Kosova o platama radnika Fabrike šavnih cevi u Uroševcu,
4. Informacija Parlamentarne grupe “6+” u vezi sa dogovorom o zamenjivanju člana Predsedništva Skupštine, kao i zahtevi nekoliko poslanika iz ostalih nevećinskih zajednica o zamenjivanju člana Predsedništva iz njihovih redova.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Kosovës, sipas rendit të ditës, të përcaktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës.

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjatë deri 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Vazhdojmë.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Kymete Bajraktari.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nga viti në vit sfidat e njëjta për MASHT-in, nuk kemi rezultate në ngritjen e cilësisë në arsim e që është edhe qëllim kryesor i Qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit, për të krijuar shtetin e dijes. Krejt kjo është se kjo Qeveri ka dështuar për të siguruar një ambient të sigurt dhe perspektivë zhvillimore për arsimimin dhe edukimin e qytetarëve tanë.

Zoti ministër, juve dhe Qeverisë tuaj, me plotë përgjegjësi po ju them, se ju mungon dija, vullneti dhe përkushtimi për ta bërë këtë.

Vitin e kaluar i kam përmendur sfidat me të cilat ballafaqohet arsimi kosovar, të cilat janë të njohura për të gjithë qytetarët tanë e sidomos për ata që punojnë në institucione arsimore.

Nxjerrja e ligjeve, krijimi i strategjive, kurrikulat, aktet nënligjore janë të domosdoshme, por çështja është se ato po mbesin plane, ide dhe dëshira se si duhet të funksionojë arsimi në Kosovë.

Cili është angazhimi juaj në rrafshin praktik, as edhe një hap i vetëm, as edhe një qasje konkrete në zgjidhjen e problemeve të përditshme të arsimit me të cilat ballafaqohen prindërit, administrata në shkolla, mësimdhënësit, nxënësit.

Ju zoti ministër nuk keni statistika se si e keni gjendjen me mësimdhënësit, të cilët kanë probleme shëndetësore, qofshin ato fizike ose psikike.

Në mësimdhënie janë të angazhuar prej moshës 60 deri 65 vjeç, 2000 mësimdhënës. Nëse 10% prej tyre kanë probleme shëndetësore, atëherë po i bie 200 mësimdhënës nuk janë në gjendje për të punuar me ditarë. E nëse e llogarisim punën me nxënës të këtyre mësimdhënësve në nivele të ndryshme, përafërsisht këta mësimdhënës punojnë me 10 000 nxënës.

Edhe pse e kemi ngritur si çështje, ju nuk jeni angazhuar fare. Sot, në fokus do t'i kemi inspektorët e arsimit.

Cilat janë kompetencat dhe detyrat e inspektorit? Inspektorët e arsimit janë përgjegjës, nëse konstatohet se institucioni arsimor ka bërë shkelje të ligjit dhe merr masa për mënjanimin e parregullsive, inspektorët e arsimit ndërpresin dhe ndalojnë marrëdhënien e punës së mësimdhënësve dhe punëtorëve të tjerë arsimorë, të krijuar pa konkurs publik dhe në kundërshtim me standardet, normativin dhe dispozitat tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës.

Zoti ministër,

A jeni në dijeni se disa nga inspektorët e arsimit nëpër zyrat rajonale kanë filluar të punojnë pa u bërë hapja e vendeve të punës me konkurs, fillimisht 3 muaj me kontratë mbi vepër. Domethënë, në atë kohë është njohur sikur dukuria e parashutizmit, pastaj janë pranuar në marrëdhënie pune duke e shkelur Ligjin për pranimin e inspektorëve në punë, neni 3 paragrafi 3.3, nën b).

Cili është morali i këtyre inspektorëve që të kërkojnë nga të tjerët që ta respektojnë ligjin deri sa vet e kanë shkelur atë?

Kush do të më jap përgjigje në pyetje, se pse në komunën e Rahovecit shkollimi i mesëm e i lartë ende nuk është i profilizuar.

Shkollat e mesme quhen shkolla të mesme të larta....

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Vazhdojmë tutje. Në emër të Grupit, a?

*(Ndërhyrje)*

Për pikën tjetër. Atëherë, Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Dua të ngre një çështje e cila është problematizuar dhe vazhdimisht shkon në rrjet të tillë, por sidomos kohëve të fundit ishte edhe shqetësimi i ngritur nga disa kolegë deputetë këtu rreth përkujdesjes edhe përkushtimit të Kosovës për trashëgiminë fetare ortodokse.

Siç jeni në dijeni, këto problematika, përveç që janë ngritur këtu janë fryrë shumë edhe nga mediat, por fatkeqësisht raportimet e tilla ndikojnë keq në imazhin e Kosovës dhe ka pasur edhe raporte në Këshillin e Sigurimit.

Për të larguar edhe shqetësimin e vet kolegëve këtu dhe të popullatës serbe në këtë drejtim, dua t'i përmend disa fakte rreth dëmtimit të kishave që tash janë bërë nga individë të caktuar.

Dua të them e para se çfarëdo dëmtimi ne na shqetëson, pavarësisht se nga vjen, megjithatë paragjykimet se kush mund të jenë dëmtuesit, duhet të jetë një çështje e veçantë për t'u debatuar këtu.

Nga rasti i fundit të dëmtimit të kishave është parë se këto i dëmtojnë pjesëtarët serbë, siç e kemi rastin e nëntëfishtë të dëmtimit të kësaj trashëgimie nga pjesëtarë serbë, prandaj do të ishte një sinjal i mirë që secili të ndalet e kërkojë përgjegjësi në komunitetin e vet që këto gjëra të shikohen me korrektësi, së pari nga vetë ne dhe normalisht, nga institucionet.

Prandaj, duhet të ketë kujdes edhe në imazhin e Kosovës dhe në përkushtimin e saj në këtë drejtim ngase çështjet e tilla të cilësuar kësioj kanë ndikuar edhe në një status jo të mirë edhe të vetë shtetit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Rexhep Selimi e ka fjalën. Në emër të Grupit i ke pesë minuta.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Skandal pas skandali, krejt Qeveria e Kosovës, e në veçanti Ministria e Punëve të Brendshme, duket se po shkojnë drejt skandaleve të reja.

Në vargun e shumë skandaleve dhe pas njërit nga skandalet- model te kësaj Qeverie, siç ishte ai tenderit me pasaporta, që tashmë është objekt i drejtësisë, duket në sfond një skandal i ri.

Pasi që 1 milion e 400 mijë euro përfunduan në xhepat e kostumeve të shtrenjta të qeveritarëve dhe këshilltarëve të tyre, si duket, në vend se tash të frikoheshin për atë çfarë e kishin bërë, ata veç janë trimëruar dhe po vazhdojnë marshin e tyre përpara.

Tenderi i ri për furnizim me pasaporta elektronike nr. 21413014111 që parasheh kontratë trevjeçare për furnizim me pasaporta për qytetaret e Republikës së Kosovës, si duket do të jetë vetëm repriza e përpunuar e tenderit të mëhershëm që përfundoi me prishjen e kontratës dhe që u kthye ne objekt të drejtësisë. Kjo duket të jetë thjesht një përsëritje edhe më e guximshme se sa ajo e mëparshmeja, madje tashmë është kompletuar edhe më shumë ekipi i atyre që kanë dalë për gjah për të kërkuar kompani”, të ashtuquajtura “bashkëpunuese” për projektin e tyre financiar.

Madje, anëtarët e atij ekipi gjahtarësh, ju të nderuar deputete të pozitës, sapo i votuat për t’iu dhënë mundësi edhe më të mëdha për punët që ata i kryen vetes dhe qeveritarëve, afëra të tilla në fushën e privatizimit në Kosovë.

Por, le të mbesim te skandali i cili po pret në radhë. Siç edhe keni mund ta shihni sot në shtypin ditor, specifikat, teknikat e tenderit të furnizimit me pasaporta janë të përshtatura për ta favorizuar një kompani dhe për t’i diskriminuar kompanitë e tjera. Pra janë përshkruar specifikacione të cilat kanë si adresim fituesin.

Si pasojë, janë tërhequr nga kjo garë edhe kompani shumë serioze të nivelit botëror, si nga Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Një ndër shkeljet më skandaloze në këtë menaxhim politik të këtij tenderi është edhe mosrespektimi i afateve ligjore, por që do të mundësonte përgatitjen e kompanive të interesuara për këtë garë. Me këtë gjë, është shkelur neni 44, pika 1, 2 dhe 2.1 e Ligjit për prokurim publik në Republikën e Kosovës.

Unë sot po ju paralajmëroj juve dhe qytetarët e Kosovës se në radhë është një keqpërdorim i madh me pasaportat e Kosovës. Ministria e Punëve të Brendshme, nuk do t'ia arrijë që të prodhojë më shumë pasaporta se sa skandale. Prandaj, dorëheqja apo shkarkimi i menjëhershëm i ministrit të skandaleve do ta shpëtonte Kosovën nga një skandal i ri dhe do t'u mundësonte qytetarëve pasaportat e tyre.

Në të kundërtën, ne mund ta kemi ende këtë ministër, por më e pakta nuk do të kemi pasaporta. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Deputetja Valbona Dibra e ka fjalën.

**VALBONA DIBRA:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderur kolegë deputetë,

Në dhjetor të vitit 2011 në Esen të Gjermanisë ishin gjetur disa artefakte që dyshohej se ishin të trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Me marrjen e informatës nga Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, e po ashtu edhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, rastin e kanë trajtuar me prioritet dhe seriozitet të lartë dhe i kanë aktivizuar të gjitha mekanizmat përgjegjës për identifikimin dhe kthimin e artefakteve në Republikën e Kosovës.

Pas një pune maratonike, gati dyvjeçare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ambasadës së Kosovës në Berlin, e me theks të veçantë punës së palodhshme dhe shumë profesionale të sekretares së parë në Berlin, që është përgjegjëse për kulturë, sot Kosovës po i kthehen shtatë artefakte të cilat më 19 shkurt i ka prezantuar zyrtarisht ministri i Kulturës zoti Memli Krasniqi dhe ministrja e Shkencës e Arteve në Esen, zonja Eva Kuhne Horeman. Prandaj, që nga sot Muzeut Arkeologjik të Kosovës i shtohen edhe këto shtatë artefakte që janë vetëm një pjesë e shumë artefakteve që sot i mungojnë Kosovës.

Me këtë rast dua ta falënderoj Ministrinë e Artit e Shkencës së Esenit për kujdesin e lartë që e ka treguar për artefaktet e Kosovës, duke dëshmuar lart bashkëpunimin dhe kulturën e lartë të popullit gjerman.

Ndërsa, duke përgëzuar Ministrinë e Kulturës dhe të gjithë ata që kontribuan për kthimin e këtyre artefakteve, urojmë që të bëhet krejt çka është e mundur që Muzeut Arkeologjik të Kosovës t'i kthehen të gjitha artefaktet e munguara. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Mursel Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Hvala predsedniče Skupštine!

Uvaženi ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Želeo bih da pokrenem jedno pitanje koje je veoma aktuelno ovih dana u regionu. Naime radi se o sledećem: Kao što znamo, podatak da na Kosovu se uglavnom uvozi mleko a kao što sam i rekao, u regionu postoji veoma velika zabrinutost da je to mleko koje se uvozi zagađeno, da ne kažem, odnosno da ima sastojke kancerogenih elemenata, aflatoksina i ostalih pa sam hteo da ovo pitanje iznesem pred Skupštinu i da zamolim i resornog ministra zdravlja a i Skupštinsku komisiju za zdravlje da pokrene ovu inicijativu i nadležno ministarstvo inspekcije da odrade posao vezan za kvalitet odnosno kakvo to mleko piju naša deca odnosno svi mi.

Pitanje je veoma ozbiljna i ne bih želeo da se preko ovoga prođe jednostavno, pa vas zato molim da se jedna ozbiljna akcija pokrene povodom ovog pitanja i da Skupštini u najkraćem mogućem roku budu dostavljeni podaci i izveštaji o tome kakvo se mleko pije na Kosovu s obzirom, ponavljam na činjenicu da se uglavnom mleko na Kosovu uvozi iz regiona. Samo toliko! Hvala!

KRYETARI: Deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Poštovani predsedniče Parlamenta,

Poštovane kolege poslanici,

U opštini Dragaš se u poslednje vreme dogodilo više incidenata u kojima su napadnuti pripadnici Bošnjačke i Goranske zajednice. Tako, juče 20. februara 2013. godine na radnom mestu fizički napadnut gospodin Uzeri Hamza, potpredsednik Demokratske stranke Vatan i zvaničnik za ljudska prava Kancelarije za zajednice u opštini Dragaš.

Napad na Uzeri Hamzu se dogodilo u opštinskoj zgradi, a izvršio ga službenik Ministarstva unutrašnjih poslova Kosova, zadužen za izdavanje vozačkih dozvola, Besnik Huqaj.

Ovaj incident je samo jedan u nizu napada izvršenih na pripadnike Bošnjačke i Goranske zajednice u Dragašu koji je izazvao zabrinutost, ogorčenje i oštru osudu građana Gore.

Zahtevamo od policije i nadležnih sudskih organa da preduzmu zakonske mere da se počinitelj ovog krivičnog dela izvede pred lice pravde kako bi Besnik Huqaj prestao sa verbalnim fizičkim i finansijskim maltretiranjem našeg naroda u opštini Dragaš, a od gradonačelnika opštine Dragaš gospodina Salima Jonuzija, koji je bio očevidac događaja, zahtevamo da konačno shvati ozbiljnu situaciju u opštini Dragaš i zauzme odlučniji stav u rešavanju problema kako se ovakve stvari ne bi ponavljale i kako bi se svi naši službenici i građani osećali sigurnije. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderur zoti kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Do të ngre një shqetësim në lidhje me Raportin e fundit të UNDP-ës dhe të Human Rights Watch, ku në raportin e shkallës së papunësisë, përveç një numri të madh të shumicës së kosovare e cek edhe një raport shumë shqetësues se 3/4 e komunitetit egjiptian janë të papunë dhe sidomos të papunësuar në institucionet shtetërore. Do të thotë ky është një shqetësim që jam duke e ngritur që shumë herë dhe raportet e tilla për çdo vit janë të këqija e më të këqija.

Përveç këtij raporti, është edhe raporti të cilin vet e jep institucioni – Avokati i Popullit, pastaj Ministria për Komunitete e Kthim, Zyra për Komunitete e Kryeministrit dhe është shumë absurde se mu këto institucione që duhet të merren me mbrojtjen e komuniteteve, nuk kanë asnjë pjesëtar të komunitetit egjiptian të punësuar, ndërsa e ngritin çështjen për shkallë të lartë të papunësisë.

Prandaj, nga ky vend, nga ky institucion bëj thirrje që në radhë të parë institucionet që janë të thirrur për t'i mbrojtur komunitetet së pari ato duhet t'i respektojnë. Së pari Avokati i Popullit duhet të ketë vend edhe për pjesëtarë të komunitetit egjiptian.

Gjithashtu Zyra e Kryeministrit duhet të ketë vend për pjesëtarë të komunitetit egjiptian. Gjithashtu edhe institucionet tjera e ndërmarrjet publike që i kanë 10% kuotën e caktuar me ligj duhet këto ta respektojnë. Nuk është filozofi që të punosh në KEK, që ta lexosh një njehsor ore, bile do ta lexojnë më mirë se ata që muajin e kaluar kanë bërë gabime, për t'u punësuar në KEK ose në PTK, ose në shumë ndërmarrje tjera.

Unë do ta ngre edhe një çështje tjetër, se edhe institucionet vitale të shtetit, siç janë: Policia, Dogana, Administrata Tatimore, nuk e kanë asnjë pjesëtarë të komunitetit egjiptian të punësuar. Atëherë, mund të themi se kësaj nuk i thonë diçka tjetër vetëm një diskriminim i cili duhet të ndalet dhe në vend që të ketë fjalime të mëdha, por besoj se duhet të ketë veprime të mëdha dhe duhet t'u ndihmohet atyre komuniteteve që me vite kanë qenë të shkelur, me vite kanë qenë të marginalizuar dhe me vite kanë qenë të diskriminuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Vjollca Krasniqi e ka fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Edhe çështja për të cilën do të flas sot ka të bëjë me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ditëve të fundit Ministria e Punëve të Brendshme e ka instaluar një program të ri për lëshimin e dokumenteve personale siç janë certifikatat e lindjes, certifikatat e kurorëzimit apo ato të gjendjes ekonomike.

Qeveria dhe Ministria e Punëve të Brendshme e kanë reklamuar këtë projekt si një e arritur e MPB-ës, mirëpo problemet për implementimin e këtij programi janë evidente në të gjitha komunat.

Për këtë program Ministria nuk i ka trajnuar zyrtarët komunalë dhe premtimi i Ministrisë se do të ketë zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme nëpër komuna për të ndihmuar në funksionalizimin e këtij programi, ata nuk duken gjëkund.

Të dhënat e qytetarëve është dashur që të futen më herët në data-bazë e jo tani. Dhe nuk është problemi i mosdijes së zyrtarëve komunalë për mosimplementimin e këtij projekti, mirëpo programi ka shumë probleme teknike.

E keni parë edhe vetë se në sportele të komunave ka tollovi të shumta, andaj mendoj se qytetarët nuk kanë faj që shprehin revoltë për mospajisjen e tyre me dokumente personale, por as zyrtarët komunalë nuk kanë faj për një gjë të tillë, sepse Ministria është dashur ta bëjë një pilot-projekt në një komunë dhe më pas të vazhdohet në komuna tjera.

Nëse komuna e Prishtinës ka nxjerr deri më sot deri në 1.000 certifikata të lindjes dhe tani nuk arrin të nxjerrë as 100 të tilla, mendoj që Ministria e Punëve të Brendshme do të duhej të jetë më e kujdesshme dhe të ketë një bashkëpunim më të mirë me komuna dhe jo si ka vepruar kështu dhe ua ka lënë patatën e nxehtë në dorë.

Këtu më së shumti po pësojnë qytetarët e komunave në përgjithësi. Do të ishte mirë të ishte ministri këtu, por si zakonisht, i kemi 1, 2 ose asnjë ministër. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Shaip Muja e ka fjalën.

**SHAIP MUJA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Sot do të bisedoj për një temë e cila është aktualisht duke u trajtuar në mënyrë jo njerëzore, jo shkencore, jo juridike nga Ministria e Shëndetësisë me mediet duke terrorizuar mjekët, pavarësisht ku punojnë ata, në sistem publik apo privat, duke i shfrytëzuar emisionet e RTK-ës dhe emisionet tjera të Klan Kosovës, me qëllim për t'i fshehur paaftësitë e menaxhimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe mendoj që këto janë të patolerueshme dhe të cilat nuk guxojnë të keqpërdoren nga institucionet e vendit.

Ky keqmenaxhim nuk mund të fshihet nga problemet të cilat janë të shtresuara, nuk mund t'i adresohen ligjit që ka shkuar në kushtetutë, sepse më jep të drejtën e plotë që ata gazetarë të cilët s'kanë as idenë minimale se çka është sistemi shëndetësor, ta akuzojnë sistemin ose individët dhe ta vlerësojnë sistemin se ne jemi duke dështuar.

Prandaj, kjo mua më jep të drejtë që t'i quaj influencues në vendim në mënyrë paraprake duke bërë një terrorizim mediatik mbi Gjykatën Kushtetuese.

Ministria e Shëndetësisë ka dështuar në shumë drejtime, duke filluar nga Agjencia e Barnave në keqmenaxhim, duke filluar në keqmenaxhimin e departamenteve dhe ky dështim nuk mund të maskohet në ligj.

Votat të cilat janë marrë me shumicë nga Lidhja Demokratike për këtë ligj kanë qenë jo të interesit të stabilizimit të sistemit por përkundrazi me terrorizuar sistemin, sepse dihet që ky ligj për tri vjet nuk kishte mund të implementohet. Dhe si opozitë, me veprimet e veta, i tregon veprimet që janë çdo ditë jokonstruktive dhe sot keqpërdoret se ligji nuk është votuar nga pjesa e pozitës dhe një grup i deputetëve të cilët ne i kemi nënshkruar akuzohemi edhe nga ministri se nuk e dimë çka kemi nënshkruar.

Unë e vë në dijeni ministrit që vetëm një deputet nuk e ka ditur çka ka nënshkruar. Mund t'ia përmend emrin, por tjerët të gjithë e kanë ditur dhe për të tjerët ne mund të ju mbajmë edhe shkollë çka është sistemi shëndetësor. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Për 13 vjet me radhë Serbisë i janë toleruar strukturat e saj shtetërore në veriun e Kosovës. Prej të gjitha qeverive të deritashme qytetarëve u është thënë vazhdimisht se këto struktura do të shpërbëhen.

Janë përpiluar disa strategji deri sot për shtrirjen e kontrollit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës brenda kësaj pjese të territorit tonë. Kurse, sot kryeministri i Kosovës na thotë se këto struktura do të shpërbëhen duke biseduar me Daçiqin.

Dhe kur të gjithë qytetarët e Kosovës po e prisnin pakon e liberalizimit të vizave, kjo Qeveri po na kthehet nga Brukseli me një pako tjetër, me pakon e kompromisit të ri për veriun e Kosovës, që shkon përtej planit të Ahtisarit.

Në natën që në Bruksel po flitej kinse për shpërbërjen e strukturave të Serbisë, pikërisht këto struktura po i sulmonin me bomba dhe akte terroriste shqiptarët e veriut të Tre Rrokaqiejt.

Tash negociatat me Serbinë kanë arritur në atë fazë të cilën Lëvizja “Vetëvendosje” e ka paralajmëruar qyshkur. Qeveria jonë në Bruksel për veriun e Kosovës po e vë në diskutim edhe planin e Ahtisarit.

Në fillim kur e patën pranuar Planin e Ahtisarit na thoshin se kjo pako nuk hapet, apo thoshin se nëse hapet Pakoja e Ahtisarit, do të hapet edhe çështja e Luginës së Preshevës, por në anën tjetër nuk e zbatuan këtë plan në veriun e Kosovës.

Tash vetë Plani i Ahtisarit po përfundon në tavolinën e negociatave, me vetë faktin që Qeveria jonë do ta mbajë pozicionin e Planit të Ahtisarit, kurse Qeveria e Serbisë do ta mbajë pozicionin e Platformës serbe për Kosovën.

Ky ka qenë edhe kuptimi i kërkesës së Lëvizjes “Vetëvendosje” që si qëndrim minimalist, Plani i Ahtisaarit të mos pranohet, madje pa u pranuar nga BE-ja, OKB-ja, Serbia e kështu me radhë.

Me fjalë të tjera, ky është degradim i vazhdueshëm i pozicionit politik të Kosovës karshi Serbisë dhe integritetit territorial republikan.

Tash edhe po na hapet plani i Ahtisarit, edhe Daçiçi po na i heq lapidarët e luftës çlirimtare në Luginë, kurse pushtetarët tanë milionerë nga maja e pushtetit të luksit i fajësojnë shqiptarët dhe u kërkojnë atyre qetësi.

Për këtë arsye, do të ishte mirë që edhe deputetët opozitarë që ia patën dhanë përkrahjen kësaj Qeverie për të shkuar në këto bisedime me Serbinë nëpërmjet të rezolutës, ta kuptojnë se nuk mund të shpresojmë që në ato negociata do të na mbrohet Kushtetuta jonë dhe integriteti territorial dhe sovraniteti ynë.

Përkundrazi, jemi në prag të një dëmtimi të madh të integritetit territorial të vendit tonë.

KRYETARI: Deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot do ta ngre një çështje e cila ka të bëjë pikërisht me mosfunksionimin e Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore. Kërkesat kanë qenë të vazhdueshme nga drejtoresha e këtij këshilli dhe ne kemi obligim ligjor në kuadër të ligjit për trashëgimi kulturore që ky këshill të jetë funksional.

Neni 4.8 i këtij ligji thotë: “Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është organi i cili krijohet nga Kuvendi i Kosovës, i cili përcakton edhe objektin e veprimtarisë së tij në fushën e trashëgimisë kulturore. Ai përbëhet nga 7 anëtarë të cilët zgjidhen për një mandat trevjeçar nga Kuvendi i Kosovës, duke respektuar përbërjen etnike në Kosovë, Kuvendi i Kosovës miraton buxhetin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, mënyrën e organizimit dhe funksionimin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, që do të rregullohet me një akt të brendshëm të miratuar prej këtij ligji.

Duke pa situatën e rëndë të trashëgimisë kulturore ku shumë monumente të kësaj fushe, do të thotë janë në shkatërrim e sipër, ky këshill ka për obligim që ta bëjë listën e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe t’ia dërgojë ministrit për miratim dhe për t’i futur nën mbrojtjen e shtetit.

Prandaj, mosfunksionimi i këtij këshilli vazhdon që trashëgimia kulturore në Kosovë të degradohet dhe njëkohësisht të shkatërrohet.

Sipas agjendës që e ka Ministria e Kulturës për plotësim-ndryshimin e këtij ligji të trashëgimisë kulturore, e cila e ka përgatitur ta sjell në Parlamentin e Kosovës dhe sipas

kësaj agjende ky ligj nuk do të vijë deri në qershor. Prandaj, është leximi i parë dhe pas pushimi fillon leximi i dytë dhe njëkohësisht implementimi fare se do të jetë i mundur të fillojë gjatë vitit 2013.

Prandaj, është një kërkesë urgjente dhe unë kërkoj në këtë rast nga Komisioni për Kulturë, Rini dhe Sport, Administratë dhe Media që në bashkëpunim me drejtoreshën e këtij këshilli dhe në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Kuvendit të Parlamentit të Kosovës ta rifunksionalizojë Këshillin për Trashëgimi Kulturore.

Përndryshe, me mosfunksionalizimin e këtij këshilli ne po krijojmë mundësi dhe hapësirë që trashëgimia kulturore të vazhdojë akoma më tutje të degradohet dhe njëkohësisht të shkatërrohet në tërësi. Prandaj, përpos që kemi obligim ligjor me këtë ligj, sepse ky ligj është funksional, ne kemi edhe obligim kushtetues që trashëgiminë kulturore ta ruajmë, ta kultivojmë dhe njëkohësisht ta mbrojmë si trashëgimi unikate.

Prandaj, edhe një herë po e përsëris kërkesën që në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe po ashtu me organet që janë përkatëse dhe përgjegjëse në kuadër të këtij ligji, ta funksionalizojnë Këshillin për Trashëgimi Kulturore.

Tentativat e Ministrisë së Kulturës janë që ky këshill të hiqet dhe të mos themelohet nga Kuvendi i Kosovës, por të themelohet nga Qeveria e Kosovës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Unë dua ta bëj një ndërhyrje, edhe pse nuk po dëshiroj, por realisht do të duhej Komisioni ta sjellë një raport dhe pastaj ne jo 3 minuta, por ta bëjmë një debat për këto çështje por edhe për disa çështje tjera që po ngritën, mirëpo është çështje e juaj, e ju veç po doni t' i thoni do fjalë dhe është çështje tjetër, por komisioni përkatës do të duhej ta binte një raport me gjendjen në atë fushë të caktuar. Fjalën e ka deputetja, e fundit për sot, Donika Kadaaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Mendoj që edhe tema që do ta shtjelloj në fakt ka nevojë për një debat më të gjatë, por për shkak se është urgjente kisha dashur ta filloj sot.

Secili individ gëzon të drejtën për jetën, është një dispozitë e cila përfshihet në aktin më të lartë juridik dhe politik të vendit tonë – në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Të drejtat e tilla janë të normuara dhe si të tilla sjellin detyrime për të gjitha organet dhe institucionet e Republikës së Kosovës, karshi qytetarëve të saj, të sjelljeve të vetëdijshme, të secilit qytetar ndaj njeri-tjetrit, pa marrë parasysh çdo lloj dallimi individual ndërmjet tyre.

Në kuadër të këtyre të drejtave, e drejta e pensionit, si një e drejtë e fituar absolute duhet të gëzojë edhe mbrojtje absolute nga të gjitha institucionet kompetente.

Mohimi i një të drejte të tillë, është mohim i mbrojtjes së dinjitetit të qytetarëve, të cilët për shumë vite kontribuan në ndërtimin e vendit.

Sot në Kosovë, prindërit tanë shumica e të cilëve jetojnë në varfëri ekstreme, nuk e gëzojnë këtë të drejtë, edhe më shumë se një dekadë pas lufte. Numri i atyre që kontribuan prej viti në vit po zvogëlohet për shkak të vdekjeve nga mosha ose sëmundjet e rënda, kurimi i të cilëve është i shtrenjtë dhe rrjedhimisht i pamundshëm për ta.

Kohëve të fundit ka ndodhur një lëvizje në Gjykatën e Strasburgut, janë dy raste të cilat janë për tu përshëndetur, janë individuale, mirëpo mund të jenë precedent për rastin e pensionistëve të Kosovës, të cilët priten edhe kështu tepër gjatë.

Dje dhe ditëve të tjera ishim dëshmitarë të një organizimi individual dhe sindikal të njerëzve për t'u lajmëruar në Ministri dhe kjo është një çështje urgjente me të cilën duhet të merret Qeveria.

Arsyeja që e ngrita këtë temë është nevoja, nevoja urgjente që këtë çështje ta marrë përsipër Qeveria, sepse Qeveria ekziston për t'i zgjedhur problemet e qytetarëve dhe ky është prioritet në shoqërinë tonë me shumë probleme.

E ngrita këtë çështje për të kërkuar nga ekzekutivi dhe po më vjen mirë që ministri erdhi këtu, veprime konkrete eksplicite dhe pragmatike që do të japin rezultate konkrete në afate optimale kohore në mënyrë që qytetari i Kosovës, pensionisti të zbatojë të drejtën bazë për jetë.

Dje në një nga përgjigjet e ministrit të drejtuar qytetarëve ishte pak a shumë që mos pritni shumë. Unë e thërras Qeverinë e Kosovës që të bëjë veprime shumë në mënyrë që qytetarët e Kosovës, pensionistët e Kosovës të marrin në rend të parë informatë se cilat janë veprimet që ata duhet t'i ndërmarrin si individë dhe pastaj cilat janë veprimet që Qeveria po i ndërmerr që këtij problemi kaq të madh, i cili zgjati kaq shumë, t'i japë një përgjigje, që po dua të besoj, të jetë ajo pozitive.

Mirëpo, ju kisha lutur që kjo përgjigje të jetë eksplicite, të jetë shumë pragmatike...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Faleminderit! Është kaluar koha e deputetëve. Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë dhe pastaj ministri i Punës. Ministër Agani e ka fjalën.

**MINISTRI FERID AGANI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Më duhet të reflektoj pak në qëndrimet e deputetit Muja, që tash për momentin nuk është këtu, por dua t'ia përmend një gjë se me asnjë dispozitë ligjore nuk janë të ndaluara deklaratat publike, edhe pse një çështje është në Gjykatë Kushtetuese dhe ashtu siç ka pasur të drejtë ai dhe grupi i deputetëve ta parashtrijë një çështje në Gjykatë Kushtetuese,

njëjtë është e drejtë imja si ministër që në mënyrë publike t'i mbroj qëndrimet e mia, aty ku më ofrohet mundësia.

Është shumë e qartë se Ligji i shëndetësisë, dhe besoj se pajtoheni këtu me mua, është një ligj i cili ka qenë i mbështetur nga shumica e madhe në Kuvendin e Kosovës. Është ky një ligj i cili është debatuar gjatë, është ligj i cili ka pasur mbështetje të Komisionit Parlamentar të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Komisionit për Buxhet e Financa, është ligj i cili është buxhetuar edhe para që të jetë i miratuar në Kuvendin e Kosovës, sepse ka qenë i mbështetur nga Banka Botërore, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, është ligj i cili në mënyrë gjithëpërfshirëse e projekton rrugëdaljen nga kriza në të cilën shëndetësia kosovare ka ardhur jo në dy vjetët e fundit, e dini mirë, por që nga vitet e para të pasluftës. Dhe, gjatë këtij procesi unë jam shumë i lumtur që si ministër i Shëndetësisë e kam pasur përkrahjen e të gjitha grupeve parlamentare dhe kjo është dokumentuar edhe në momentin e votimit të këtij ligji në Kuvend të Kosovës, kur i mori 43 vota, përkundër 18 votave kundër.

Unë nuk e kam pritur iniciativën ligjore në Gjykatë Kushtetuese, të them të drejtën dhe veçanërisht jo nga deputeti Muja, sepse ai në vetë seancën nuk ka votuar kundër ligjit, por ka abstenuar, dhe në njëfarë mënyre e ka treguar një rezervë të tij, por ky qëndrim i vendosur në Gjykatë Kushtetuese duhet të them se i ka ndalur në masë të dukshme proceset reformuese në vend. Konkretisht, një projekt i Bankës Botërore në vlerë prej 670 mijë dollarë nuk ka mund të realizohet për shkak se ky ligj nuk është në fuqi dhe për këtë edhe nuk jemi duke mund të fillojmë t'i ndërtojmë kapacitetet e Agjencisë të Financimit të Shëndetësisë, dhe shumë aspekte të tjera, mungesa e zbatimit të ligjit praktikisht i ka qitur prej binarëve normal zhvillimet në shëndetësinë kosovare, apo zhvillimet reformuese.

Pra, përkundër kësaj, ne do të vazhdojmë të punojmë dhe shpresoj shumë shpejt se edhe në dëgjimin publik që do të organizohet në fillim të marsit, do të kemi rastin që t'i ballafaqojmë argumentet në mënyrë të qartë, ndërsa kur është në pyetje terrorizimi mediatik, unë mendoj se terrorizimi mediatik është kah ndodh shumë më tepër me raste të qena e të paqena dhe të konstruktura në shëndetësinë kosovare duke provuar të gjenden edhe probleme aty ku nuk janë dhe duke mos i theksuar shumë anë pozitive të shëndetësisë kosovare, duke i dekurajuar punëtorët shëndetësorë dhe duke e humbur besimin e qytetarëve në sistemin publik të shëndetësisë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Deputetit Shaip Muja, dy minuta.

**SHAIP MUJA:** Unë jashtë kësaj teme të ligjit, ministrin e kam mik për njohuri tuaja dhe mund të rrimë edhe sot e 100 vjet në raporte miqësore, në raportin e organizimit shëndetësor dhe shtetëror na divercojnë idetë dhe qëndrimet që i bëhen ligjit.

Çështja e përkrahjes, unë të lus zoti ministër, Banka botërore nuk ta ka cilësuar, as Fondi Monetar ligjin nga aspekti funksional, por nga aspekti monetar, prandaj, të lutem mos u deklaro në këtë mënyrë. Nuk e ke asnjë shkrim.

Problemi financiar është i vlerësuar si për ty, si për të gjitha ministrinë. Problemi që paraqitet këtu se ky ligj do ta nxjerr shëndetësinë nga kriza, nuk qëndron. Prandaj ti nuk ke pasur nevojë, unë të kam thënë edhe në prapavijë para se me ardhur ligji në mënyrë shoqërore, mos i sjell këto nene sepse do t'i kundërshtoj dhe këtu t'i kundërshtojnë 6.300 nënshkrime të sindikatave, ata nuk janë as fëmijë, punonjës shëndetësorë janë dhe të cilët janë duke e bërë një punë titanike, ndërsa gazetarët mundohen për interesat e tyre që janë të interferuar thellësisht në kriminalitet ekonomik. Nëse donë mund t'ia përmendi edhe me fakte dhe me emra, nuk ka nevojë të na moralizojnë neve këtu, sepse shëndetësia është duke bërë një punë titanike e cila nuk vlerësohet nga sistemi i Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, shkurt!

MINISTRI FERID AGANI: Pajtohem plotësisht se shëndetësia është kah bën punë titanike në rrethana të vështira, por duhet mundësuar një sistem shumë më adekuat ku mund ta shprehë veten dhe unë dua të theksoj edhe një herë se është plotësisht e pavërtetë që Ligji i shëndetësisë dhe Ligji i sigurimeve shëndetësore që janë punuar bashkë me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar kanë vlerësuar vetëm aspektin financiar. E ka vlerësuar përmbajtjen e ligjit. Banka Botërore, se ju keni pak mungesë të njohurive lidhur me mënyrën si punojnë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në përpunimin e legjislacionit.

Fondi Monetar Ndërkombëtar vlerëson aspektet financiare të ligjit, stabilitetin makroekonomik e fiskal të vendit. Banka Botërore ka ekspertë, ekipe të ekspertëve nga të gjitha vendet e botës që të vlerësojnë funksionalitetin e ligjit, përmbajtjen e tij, integrimin e ligjit me sektorë tjerë të ekonomisë dhe veçanërisht me sektorin financiar.

Prandaj, të ndalësh një ligj i cili për herë të parë pas luftës është mbështetur fuqimisht nga Banka Botërore dhe fondi Monetar Ndërkombëtar, mendoj se nuk ka qenë punë e mençur dhe shëndetësia kosovare që thatë po bën punë titanike është dëmtuar shumë.

KRYETARI: Faleminderit!

Zoti ministër dhe të nderuar deputetë,  
Çështja e shëndetësisë është një çështje vërtet serioze dhe nuk do të duhej të trajtohej në këtë pikë të rendit të ditës. Grupi i Partisë Demokratike me Lidhjen Demokratike kanë më së shumti deputetë në Komisionin për Shëndetësi. Le të shkojnë ta bëjnë një raport dhe ta sjellin këtu e të diskutojmë për shëndetësinë, se ia vlen, por nuk ia vlen në këtë pikë të rendit të ditës. Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Gospodo Bujupi, meni je stvarno žao, nisam znao da ćete pokrenuti ovo pitanje, doneo bih originalno obaveštenje koje dolazi iz autoriteta Republike Srbije gde je PIO -

takozvani PIO fond dao saopštenje kako bi trebali da izgledaju i aplikacije i ko ima pravo na apliciranje.

Ja ono što sam rekao juče, apsolutno mislim da je najmanje što smo mogli da uradimo jer okolnosti koje su nastale bili na terenu, faktički bile da su podležne da tako kažem manipulacije penzionera u cilju ne znam kojih interesa da bi oni u što većem broju aplicirali a zvanično obaveštenje kaže da svi koji dostave rešenje o penzijama, naravno pre 99. godine sa ličnim identifikacijama po zakonima Republike Srbije, što bi konkretno značilo da svako od njih mora da ima rešenje iz koje godine da je i da naravno dođe sa ličnom kartom koja je validna.

Drugo. Kaže potvrda od UNMIK-a da jesu odnosno da nisu primali penzije iz privremenih institucija samouprave u Prištini, što znači da jeste Ministarstvo nadležno zbog toga što UNMIK nikako nema spiskove ko je primao penzije ko nije i jeste da samo mi možemo faktički da odgovorimo na ono što oni traže, a da ne pominjem to identifikaciju, koje treba da bude validna lična karta naravno i da ne pričamo o tome da imaju rešenje koje treba da prilože uz tu njihovu identifikaciju što znači da jedini realan pristup bi bio da Ministarstvo za rad, kao što će verovatno i biti, u udobno vreme možda postane partner na tehničkom nivou sa Ministarstvom Srbije gde bi te informacije mogle biti razmenjivane.

E šta smo mi uradili u vezi toga? Mi smo inače još prije četiri meseci kada je bila prvi put pomenuto da će početi pregovori, i ja sam to na Vladi tražio i od premijera, da Ministarstvo za rad pripremi jedan osnovni dokument koji bi bio napravljen u dve kategorije - prava bi bila penzije i druga nazvali smo je socijalne usluge u globalu, zbog toga što nam je bilo potrebno kao incijativa da bi to bilo predloženo na dijalogu.

Pozvao sam još jednom ako niste znali, na prošloj sednici Vlade gde smo tražili da Ministarstvo za rad ima mogućnost da pošalje svoju tehničku ekipu kao deo tehničke ekipe Vlade koja će razgovarati o problematiji penzija.

Jedino tako ćemo moći da dođemo do nekog kompromisnog rešenja koje će sigurno biti ispoštovana i sa jedne i sa druge strane. U suprotnom na ovaj način pošto sam vam rekao samo nekih od tačaka, a inače poslaću vam e-mailom sa ono prevedeno saopštenje na albanskom jeziku - šta se sve traži u vezi samih penzija.

Pored toga, treba da znate da u Strazburg mogu da šalju dokumentaciju svi oni, bilo individualci, bilo kolektiv, koji su oštećeni ali samo kada prođu sve procedure na lokalnom nivou, što bi u ovom slučaju, opet praktično značilo da svi ti penzioneri odavde prvo pored toga što se žale sudu u Srbiji treba da prođe i viši sud u Srbiji pa tek onda da dobije zeleno svetlo da ide u Strazburg.

Ponavljam i ja sam siguran ovo što kažem da jedini pravi svrsishodan i efikasan način bi mogao da bude samo ukoliko Ministarstvo za rad napravi jedan tehnički nivo saradnje sa Ministarstvom u Srbiji gde može biti razmena informacija normalna. Sada ovo što je urađeno objavljeno čisto, da ja moram tako da nazove, možda reda radi.

I ako bih mogao samo jedno objašnjenje za gospođu Kajtazi, a ona nije tu sad, malopre je pomenula da su Srbi bili okrivljeni za rušenje crkava. To je pogrešno formulisano, 150 nadgrobnih spomenika je bilo srušeno, za šta ima i privedenih, ima i okrviljenih, a desila se pljačka jedna za koju je jedan pripadnik Srpske nacionalnosti uhapšen. Znači to su dva različita pojmovi. Nije za rušenje. Za krađu crkve da, jedan Srbin je uhapšen a za rušenja nadgrobnih spomenika uhapšeno je 5 lica koja tek treba da dokaže da li su krivi. Hvala gospodine predsedniče!

KRYETARI: Donika Kadaž-Bujupi, shpresoj për një minutë e kryen.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Mendoj se komunikimi ndërmjet juve dhe Qeverisë nuk është i rëndësishëm për qytetarët e as për Kuvendin, as forma si e zgjidhni problemin. Nuk ka nevojë për prova të shumta për të dëshmuar se Fondi Pensional është vjedhur, është vjedhur nga Serbia dhe mendoj që në nivelet cilat do qofshin teknike ose politike, është koha e fundit që për pensionistët e Kosovës të fillojnë zbatimin e drejtën e tyre, që është e drejtë bazike t'i marrin pensionet për të cilat kanë kontribuar gjatë kohës sa kanë punuar. Pavarësisht se çka thotë ose cilat kërkesa nevojiten nga UNMIK-u ose institucionet tjera sot është Qeveria e Kosovës përgjegjëse t'i japë përgjigje qytetarëve të vet për këtë problem shumë të madh, ministër.

KRYETARI: Ministër, shkurt urdhëro!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom. Samo što se tiče boljeg informisanja građana i vas.

Fond koji je postojao i tada pre '99 je bio takozvani fond solidarnosti koji funkcioniše na način iz kojeg vi iz jednog đepa uzimate doprinos radnika i dajete penzionerima. Znači ne postoji fond koji se akumulira u bilo kojoj formi. Nije TRUST i moram da kažem i daje TRUST mnogo napredniji sistem funkcionisanja penzionog sistema ili uštede nego što je tad bio. Tako da nije postojao nikakav opravdani dokaz da su ta sredstva postojala u tom određenom momentu i na tom određenom mestu i da je bila ukradena. Prva stvar.

Druga stvar. Da treba da ostvare svoje pravo, pa naravno, to pravo je univerzalno. Niko ne sme da im uzima pravo od onoga što zaradi i da dobiju, ali opet ponavljam jedini način da se to utvrdi i da naši penzioneri dobiju i ostvare svoje pravo je preko Ministarstvo za rad i zbog toga sam rekao da bi bila ta čista špekulacija ukoliko bi ljudi bili zloupotrebljavani na način koji nije primeran, da im se uzima, koliko - 2, 5 ili 10 evra, i to nije bitno nego je sam način deluje kao jedna vrlo nekulturna da kažem obmana. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, por para se të vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës Grupi 6+ e ka bërë një kërkesë që pika e katërt e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër. Ne na duhet një votim formal.

Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? 2 kundër. Faleminderit!

Vazhdojmë. Është pika e dytë:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Çështja ka qenë rreth Grupit “6+” dhe ata kanë kërkuar të shtyhet dhe unë mendoj që Kuvendi bëri mirë që e pranoi kërkesën e tyre.

Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta bësh pyetjen.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Po, do ta bëj pyetjen, edhe pse kryeministri është në udhëtimin e tij rreth botës, udhëtim turistik, por edhe kur ishte këtu nuk u përgjigj.

Sido që të jetë, pyetja ime lidhej me çështjen e donacioneve të premtuara për Kosovën, pas shpalljes së pavarësisë nga vende të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se sa këto premtime të këtyre shteteve janë mbajtur, pra sa para ka marrë nga Konferenca e Donatorëve Qeveria e Kosovës dhe ku janë investuar ato para?

E dimë që një pjesë e këtyre parave janë bërë pjesë e buxhetit të Kosovës nëpër vite, që do të thotë se nuk ka pasur asnjë lloj projekti apo plani në mënyrë që këto para të sillnin zhvillim për shtetin e Kosovës.

Pra, kërkesa ime ka qenë të marrim vesh sa para janë marrë dhe ku janë investuar, mirëpo, fakti se kryeministri i shmanget kësaj pyetjeje, do të thotë se nuk ka se çfarë të raportojë? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Nazane Breca, pyetje për ministrin Ferid Agani.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Çështja që ndërlidhet me pyetjen time sot ka të bëjë me kardiokirurgjinë. Kardiokirurgjia asnjëherë më herët nuk ka ekzistuar në institucionet tona publike.

Në vitin 2008 ka filluar një projekt i përbashkët i Ministrisë dhe donatorëve në aftësimin e ish-Ortopedisë, kati i pestë, domethënë në QKUK për qëllime të kardiokirurgjisë. Punimet, sa kam njohuri, kanë përfunduar. Është fituar një hapësirë rreth 100 m<sup>2</sup> për qëllim të kardiokirurgjisë dhe kanë mbetur tash punimet tjera.

Tash jemi në vitin 2013 dhe ende nuk është funksionalizuar kjo pjesë. Pyetja ime është: Kur pritet që kjo pjesë e QKUK-së të funksionalizohet dhe t’u ofrojë shërbime të kardiokirurgjisë pacientëve tanë, sepse ende 60% të buxhetit, që ndahet për pacientë për shërim jashtë vendit, domethënë, shpenzohen për qëllime të kardiokirurgjisë.

KRYETARI: Ministër e ke fjalën, por përkthimi mungon.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuara zonja deputete,

Në një pyetje të ngjashme jam përgjigjur në seancën e fundit të Kuvendit, por po e përsëris, shkurt.

Të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e punës së Shërbimit Kardiokirurgjik janë përfunduar, sa i përket Qendrës së Klinikës Universitare të Kosovës. Jemi duke e pritur ekipin e kardiokirurgëve nga Italia, gjatë javës që vjen praktikisht dhe mendoj që ne me datën 28 shkurt, pra të enjten që vjen do të kemi intervenimet e para dhe pastaj vazhdimin e tyre në mënyrë të rregullt.

Ekziston një projekt mbështetës i Qeverisë Italiane në vlerë prej 1.8 milionë euro, që do të sigurojë një qëndrueshmëri të shërbimeve deri në momentin kur Shërbimi Kardiokirurgjik, që do të themelohet në bazë të Ligjit të ri të shëndetësisë, të jetë në gjendje që të gjenerojë të hyrat financiare ta mbajë dhe ta zhvillojë veten më tutje.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë apo do me e bë pyetjen e dytë? Urdhëro, bëje pyetjen e dytë!

NAZANE BRECA: Para një kohe në Ministrinë e Shëndetësisë, nga lista esenciale e barërave janë larguar dy citostatikë, ondosetron dhe granisetron dhe janë zëvendësuar me një tjetër - palanosetron, që kushton shumë më shtrenjtë se këto dy dhe mbulojnë vetëm 10% të nevojave të pacientëve për citostatikë.

Pyetja ime është: Çka keni ndërmarrë në lidhje me këtë çështje, sepse ky citostatik i ri, që është futur në listën esenciale të barërave ka dalë se kushton disa qindra herë më shtrenjtë se këto dy tjerat dhe mbulon një pjesë shumë të vogël të nevojave të pacientëve?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Unë këtë pyetje po e dëgjoj tash. Mua nuk më ka ardhur në ministri, në formë të shkruar, me siguri për shkaqe teknike, po nuk prishë punë asgjë, jam mirë i informuar lidhur me çështjen.

Kjo ka çështje ka qenë arsyeja që unë sot në Ministrinë e Shëndetësisë e kam Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës, i cili është duke e audituar tërë procesin e prokurimit të barërave në vitin 2012.

Unë nuk e kam nënshkruar kontratën, e cila më është sjellë, për t'u nënshkruar, përkitazi me preparatin palanosetron për një arsye të vetme, sepse vlera e kësaj kontrate i ka tejkaluar shumëfish vlerën e mjeteve financiare në diskonim, që kanë qenë subjekt i deklaratës për disponueshmërinë e mjeteve financiare.

Meqenëse, ka ekzistuar një mospërputhje e qartë ndërmjet mundësive financiare të Ministrisë dhe kërkesave njëkohësisht, që kanë ardhur nga institucionet shëndetësore, unë e kam parë se një gjë e tillë është e pamundur të nënshkruhet dhe të mos dëmtohet Buxheti i Kosovës, dhe të mos dëmtohen interesat e pacientëve.

Sa u përket atyre dy antiemetikëve ose substancave kundër vjelljes, që janë përdorur më herët, që janë larguar nga lista esenciale, unë kam kërkuar nga komisioni, i cili është tash duke e shqyrtuar listën esenciale të barërave, që ata të kthehen në listën esenciale të barërave, domosdo, ndërsa, e tërë kjo situatë, siç e thashë në fillim, është duke u shqyrtuar nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës. Në bazë të rekomandimeve të tyre unë do të veproj më tutje.

Ka qenë një situatë, e cila ka reflektuar qartë dobësitë enorme në planifikimin e barërave nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet shëndetësore, vetë klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, por edhe planifikimit të buxhetit për sektorin farmaceutik.

KRYETARI: A ke pyetje shtesë, deputete?

NAZANE BRECA : Me siguri që Komisioni, i cili e ka bërë përzgjedhjen e barërave ka bërë gabim ose shkelje të rregullave, sa i përket ligjeve, rregullave të prokurimit. Mua po më intereson, se pasi që mbasi që dalin rezultatet e auditimit, çka do të ndërmerrni në lidhje me anëtarët e Komisionit që e kanë bërë këtë shkelje, sa i përket përzgjedhjes së barërave në listën esenciale të barërave? Faleminderit?

MINISTRI FERID AGANI: Unë qysh tash kam kërkuar nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë, përcaktimin e qartë të përgjegjësisë në tri nivele:

- Në nivelin e komisioneve për planifikimin e barërave në institucionet shëndetësore, që kërkojnë barëra në sasi dhe në lloje, të cilat nuk ju nevojiten, nën një.
- E dyta, Komisionit për përpilimin e listës esenciale të barërave, që ka punuar gjatë verës së kaluar, pse janë hequr ato preparate nga lista esenciale, me një arsytim të qartë?
- Dhe e treta, nga vetë Ministria e Shëndetësisë, sekretari i përgjithshëm, si ka mundur të ndodhë që buxheti i përcaktuar për blerjen e barërave dhe materialit harxhues, të mos jetë i specifikuar në kategoritë e veçanta farmaceutike, por ka qenë një buxhet i lënë gjer 17,5 milionë euro, për të gjitha barërat, materialin harxhues, vaksinat, e tjerë.

Pra, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës do të japë përgjigje të qartë lidhur me këtë dhe unë do t'i ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara ligjore, në të tri nivelet e përgjegjësisë, siç thashë më parë.

KRYETARI: Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Agani.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Gjatë vizitës që i është bërë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, respektivisht Klinikës Gjinekologjike nga personeli punonjës është konstatuar se kapëset e kërthizave të foshnjave janë jokualitative dhe të dëmshme për foshnjat.

Pyes ministrin e Shëndetësisë: A jeni në dijeni për kualitetin e dobët të këtyre kapëseve, zoti ministër? A do të merrni masa lidhur me evitimin e tyre dhe sjelljen e kapëseve më kualitative dhe në pajtim me standardet evropiane?

*(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Zoti ministër Agani, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara zonja deputete,

Ministria e Shëndetësisë e bën furnizimin e institucioneve me barëra dhe material harxhues dhe në këtë kuadër është bërë edhe furnizimi me kapëset e kordonit umbilikal.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka qenë e informuar në mënyrë zyrtare me shkrim asnjëherë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, për cilësinë e dobët të këtyre kapëseve, por ka qenë në dijeni, për shkak të ankesave të cilat janë bërë në Barnatoren Qendrore nga ana e kryeinfermiereve të shërbimeve përkatëse.

Departamenti i Farmacisë gjatë vitit 2012 ka pasur takim drejtpërdrejt me operatorin ekonomik, të cilit i është shprehur pakënaqësia e hapur në kualitetin e këtyre kapëseve dhe është marrë premtimi se ai do t'i përcjellte vërejtjet tona tek prodhuesi.

Është bërë fjalë për një kontingjent të këtyre kapëseve, i cili në asnjë mënyrë nuk i ka dëmtuar foshnjat, sepse bëhet fjalë për kapëse, që përdoren për kordonin umbilikal, por dëmi ka qenë në atë se për shkak të mosefikasitetit të mekanizmit të mbylljes së këtyre kapëseve, për të arritur funksionin, pra mbylljen e qarkullimit të gjakut nëpër kordonin umbilikal është dashur të përdoren dy kapëse, pra të shpenzohet më tepër se sa që ka qenë e planifikuar. Pra, këtu ka qenë ai dëm.

Qe katër muaj këto kapëse nuk janë më në përdorim në Qendrën Klinike Universitare, në Klinikën Gjinekologjike, sipas informatës sot që kam marrë nga drejtoresha e Klinikës Gjinekologjike dhe Obstetrike.

Dua ta theksoj këtu një çështje, se Ministria e Shëndetësisë është shumë e pakënaqur për kufizimet ligjore, që po dalin nga Ligji i prokurimit, përmes të cilit kriter absolut dhe madhor, për fitimin e një tenderi edhe për barëra e material harxhues, nga një operator ekonomik, është oferta me çmimin më të ultë. Në shëndetësi, kjo shumë herë nuk mund të zbatohet dhe shkon drejtpërdrejt në dëm të cilësisë së shërbimeve.

Aktualisht, Ligji i prokurimit publik është në proces të rishqyrtimit dhe Ministria e Shëndetësisë e ka ngritur grupin e punës, i cili është duke përgatitur propozime konkrete për ndryshimin e tij, në mënyrë që të mos kemi këso situatash më.

KRYESUESI: A ke pyetje shtesë, zonja deputete?

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, zoti ministër!

Unë kam qenë në vizitë para një muaji dhe këto kapëse, ju po thoni që para katër muajve, domethënë, i kanë pru shtesë tjera. Nuk është e vërtetë, se para një muaj ditësh, po këto kapëse kanë ndodh te foshnjat e porsalindura, që i kanë përdorë këtu në Repartin Gjinekologjik.

Ju, zoti ministër, mua po më duket se këtu nuk keni marrë kurrfarë masash. Dhe, po më duket se në këtë shekull, po dihet se si po trajtohen fëmijët e porsalindur. Këtu është një mëkat i madh, zoti ministër!

KRYESUESI: Zoti ministër e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Zonja deputete,

Unë ju dhashë informatën e ditës së sotme, nga drejtoresha e Klinikës Gjinekologjike Obstetrike, se kapëset e bardha, kapëset me ngjyrë të bardhë janë në përdorim në këtë klinikë, kapëset me ngjyrë të kaltër, që kanë pasur cilësi të dobët janë përdorë para katër muajve, gjatë muajve të verës.

Pra, kjo është një informatë zyrtare, nga drejtoresha e Klinikës. Ndërsa sa i përket përkushtimit të Ministrisë së Shëndetësisë për foshnjat e porsalindura, po ju theksoj që sot e kemi pasur një tubim në nivel mjaftë të lartë edhe me partnerët tanë, donatorët ndërkombëtarë, në të cilin e kemi bërë planin operativ lidhur me një zotim, të cilin unë si ministër i Shëndetësisë e kam nënshkruar në Uashington, në korrik të vitit të kaluar, lidhur me atë se çka duhet bërë për të reduktuar vdekshmërinë e foshnjave dhe për të arritur mbijetesën e tyre.

Prandaj, të jeni të bindur, se edhe ky rast edhe kjo informatë që e dhatë sot do të shqyrtohet në mënyrë shumë serioze. Dhe, të gjithë ata që ofrojnë informata të pasakta do të japin përgjegjësi për ato informata, sepse fjala publike, unë thashë, ka peshë shumë të madhe dhe është duke u punuar në shumë aspekte, për të rrënuar besimin e qytetarëve në shëndetësinë publike.

Por, unë thashë edhe njëherë do të vërtetojmë edhe këtë deklaratë që e dhatë tash dhe do të marrim të gjitha masat, në pajtim me faktet objektive të cilat ekzistojnë. Nuk është vështirë të vërtetohet kjo!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Kymete Bytyçi, ka pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

KRYESUSI: E keni pyetjen për ministrin Nenad Rashiq.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar zoti ministër,

A jeni në dijeni se një pjesë e punëtorëve të ish- institucioneve të Kosovës, janë të larguar nga puna pa vullnetin e tyre nga ish- regjimi serb, në vitin 1990?

Kjo kategori e punëtorëve nuk e fitojnë të drejtën e pensioneve të parapara me ligjet pozitive të Kosovës, ndërsa ata të cilët kanë punuar deri në vitin 1999, janë në pozitë shumë më të favorshme juridike dhe marrin pensionin e plotë.

Pyes ministrin, se çka jeni duke ndërmarrë në këtë drejtim për realizimin e se drejtës të këtyre punëtorëve, të cilët i ka larguar me dhunë regjimi serb dhe a keni në plan që t'ua njihni stazhin këtyre punëtorëve me Ligjin për pensionet, apo cilat janë mekanizmat që do t'ua mundësojnë realizimin e të drejtave këtyre punëtorëve?

KRYESUESI: Zoti ministër Rashiq e keni fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovana gospodo,

Ja sam i na prvom čitanju Zakona o penzijama pričao o ovim situacijama, da kažem o ovom broju ljudi, koji je ostao po strani, da tako kažem. Naravno, ponoviću još jednom, kao što je predviđeno i po samoj pismu o namenama, koja je potpisana 5 decembra 2012.godine od strane premijera, Ministarstva finansija i guvernera Centralne Banke Kosova, inače na strani 13, tačka 7, u stvari izvinjavam se, tačka 13, strana 7.

Ovaj broj ljudi, koji je u ovom momentu ostao po strani zbog toga što nije bilo moguće da se utvrdi eventualni kosto, odnosno eventualni utrošak, koji bi trebao biti za ovu dodatnu kategoriju, mi smo morali da idemo po sistemu da prvo usvojimo zakon, pa u periodu koji bi trebalo da bude naknadno posle usvajanja zakona, odredimo komisije koje će biti u stanju da utvrde faktičko stanje, što se tiče ovih kategorija. Što znači da od momenta kada se bude osvojio zakon, jer opet ponavljam, mi nismo bili u stanju ni na koji način nisu bili stvoreni tehnički uslovi, da utvrdimo tačan broj radnika i što je najbitnije tačan utrošak ili tačan budžet, koji bi trebalo da bude povećan za ovu kategoriju koja je predložena.

Kao zaključak, mi smo analizirali koliko bi tehnički bilo potrebno vremena. Negde bi nam bilo potrebno 6-9 meseci za proveru svih tih koji će aplicirati za ovu penziju i da njihovu proveru, odnosno da potvrdimo da oni jesu bili u tom momentu na poslu i da su bili silom određenog režima izbačeni s posla i tako da i njih ubrojimo u kategoriju kao što su i ostali penzioneri.

Znači, kratak odgovor na pitanje je: da, biće uključeni u određenom vremenskom periodu, koji nam treba da bisigurno potvrdili da oni jesu bili i imaju prava da budu korisnici ovih penzija. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, zonja deputete?

KYMETE BYTYÇI: Zoti ministër,

Kur e kam shtruar këtë pyetje e kam pasur për bazë se tani me rastin e pensionimeve po del se ata që kanë punuar prej vitit 1990 e deri më 1999 janë të favorizuar, ndërsa ata punëtorë që i ka larguar, pra regjimi serb nga puna, prej vitit 1990-ës janë të diskriminuar.

Dhe, zoti ministër, po më intereson se si e trajtoni këtë kategori të punëtorëve, që janë larguar nga puna nga pushteti serb, të cilët janë të diskriminuar atëherë dhe tani, me këtë legjislacion të ri?

KRYESUESI: Zoti ministër!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Dobro, hvala što ste još jednom ponovili isto pitanje!

Da vam kažem, te kategorije će sigurno ući u zakon koji sam rekao. Ali, je takođe tačno, toga treba da budete i vi svesni, svi ostali, da je vrlo teško dokazati ono što se desilo 1990.godine. E zato nama treba jedna procedura, koja neće trajati jedan dan ili dva. Malo pre sam rekao da će trajati od 6-9 meseci i ta procedura će imati za cilj da utvrdi ko je stvarno tačno bio izbačen od strane režima. E kad se to bude bilo utvrdilo, oni će absolutno uživati ista prava kao što uživa ova druga kategorija.

To je jedan od ne samo stav, da kažem politički moj, nego jedan od osnovnih stavova i principa Ministarstva, da svi čija su prava bila na bilo koji način ugrožena, prekršena, da se ta prava ostvare i na osnovu toga da ljudi, pogotovo oni koji su trpeli diskriminaciju i koji su bili izbačeni s posla, da dobiju penziju koju zaslužuju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja e fundit është nga deputetja Time Kadrijaj, për ministrin Agani. Zonja Kadrijaj e ke fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Po më vjen keq prej ministrit, se sot paska pasur shumë pyetje, por megjithatë pyetja është bërë.

Ministër,

Një vijë buxhetore shumë e rëndësishme është edhe ajo për trajtim të pacientëve jashtë vendit. Kryesisht, ky buxhet ndahet për pacientë dhe shërbime, që nuk kryhen në Kosovë, mirëpo ka raste kur me emergjencë kërkohet që të trajtohen pacientët, për shkak të natyrës së sëmundjes.

Si veprohet me këta pacientë, si po menaxhohet ky buxhet dhe pse për një kohë është stopuar kjo procedurë për shkak të ndërrimit të bordeve dhe komisioneve?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,  
I nderuar zoti ministër,  
Programi i Ministrisë së Shëndetësisë në ndihmë të pacientëve me nevojë për trajtim mjekësor që nuk mund ta marrin institucionet publike shëndetësore, nuk quhet më programi për trajtim jashtë vendit, por programi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike, që reflekton një ndryshim esencial në shfrytëzimin e këtyre mjeteve. Dhe, vetëm vjet ne kemi arritur 60% të buxhetit ta harxhojmë në Kosovë, nuk kemi pasur nevojë që të paguajmë institucione jashtë vendit.

Udhëzimi i ri administrativ në fuqi 02/2012 e mundëson, që në raste të veçanta të vlerësuara si urgjente nga ana e një komisioni mjekësor i lëmit përkatës, me miratim të ministrit dhe të Bordit, me një procedurë shumë të shpejtë, të mundësohet lejimi i fillimit të trajtimit të pacientit dhe më pastaj të zhvillohen procedurat e nevojshme administrative. Pra, ky miratim njëkohësisht nënkupton edhe një obligim të Ministrisë së Shëndetësisë, që do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet të cilat dalin nga ai proces i shërimit, në vlerë deri në 30 mijë euro, sa është e lejuar me udhëzim administrativ të nxjerrë nga Qeveria, që të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë.

Ministria e Shëndetësisë vetëm gjatë vitit që shkoi dhe në fillim të këtij viti ka proceduar rreth 60 raste të tilla, të vlerësuara si urgjente dhe dua të them se në shumicën e madhe të këtyre rasteve është arritur një efekt jashtëzakonisht pozitiv, sepse është ndihmuar dhe është lejuar intervenimi jashtë institucioneve publike shëndetësore në momentet më kritike për jetën e qytetarëve.

Aktualisht në Ministri, me një vendim të sekretarit të përgjithshëm është formuar grupi i punës për ndryshimin dhe plotësimin e këtij udhëzimi administrativ, me një detyrë specifike që edhe më në detaje të qartësohen këto procedura të veprimit në raste të tilla urgjente.

Në lidhje me pjesën e dytë të pyetjes, pse që një kohë është stopuar kjo procedurë, për shkak siç theksohet në pyetje, të ndërrimit të bordit dhe komisioneve, dua të sqaroj se Komisioni për Vlerësimin Mjekësor, se ky është një Komision i veçantë brenda Ministrisë, i cili i rekomandon rastet me vlerësimin e tyre Bordit për trajtim jashtë vendit, ky komision ka mandat trevjeçar në bazë të Udhëzimit 02/2012 dhe nuk e ka ndërprerë punën në asnjë moment, pra është duke punuar në vazhdimësi.

Mirëpo, mandati i ish-bordit për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, ka skaduar më 23 janar të vitit 2013 dhe me datën 8 shkurt, unë e kam emëruar bordin e ri ekzekutiv në pajtim me udhëzimin administrativ në fuqi, i cili përbëhet nga kryetari i Bordit dhe dy profesionistë shëndetësorë, që vijnë nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, deputete Kadrijaj?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, ministër, për informatën, mirëpo unë kam një rast shumë konkret, në të cilën ju kemi lutur edhe personalisht, është rasti për vajzën Diellza Nimanaj, një e re e cila është diagnostikuar si leukemi dhe me urgjencë është detyruar të shkojë në Turqi, për trajtim. Ju kam lutur personalisht që të ushtroni ndikimin e juaj në spitalet e Turqisë, që kësaj vajze t'i lehtësohet trajtimi për shkak se deri sot prindërve të saj, trajtimi i Diellzës i ka kushtuar deri në 300 mijë euro. Me procedura të rregullta administrative, Diellza ka aplikuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe nga Ministria e Shëndetësisë iu kanë ndarë 30 mijë euro.

Tash, Diellza është liruar nga spitali, mirëpo për shkak të borxhit, që Ministria e Shëndetësisë nuk e ka paguar, ajo ka mbetur peng në spitalin e Turqisë.

Çka do të bëni për rastin konkret, për Diellza Nimanaj, e cila është prej një familjeje që kanë 3-4 anëtarë të familjes dëshmorë, ndërsa as Ministria, as Qeveria deri sot nuk e kanë ndihmuar këtë rast, edhe pse shërimi ka kushtuar 300 mijë euro.

Çka do të bëhet për Diellzën? A do të mbetet Diellza peng në spitalin e Turqisë, për shkak se Ministria nuk i ka kryer detyrimet ndaj kësaj vajze, që është në trajtim në Turqi?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Zonja deputete,

Ju e dini, që personalisht kam qenë i angazhuar rreth atij rasti. Ka qenë fjala për fundin e vitit të kaluar, në kohën kur prej gushtit Ministria e Shëndetësisë s'ka pasur mjete më në fondin për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore, ndërsa kuota prej 100 rasteve, që Qeveria e Republikës së Turqisë e mbulon, pra shpenzimet për këta pacientë që ne i dërgojmë për Turqi, ka qenë e përfunduar dhe nuk kemi pasur kurrfarë mundësie në atë kohë, që t'i kryejmë obligimet tona financiare, përkundër dëshirës sonë maksimale që të realizojmë këtë.

Ajo që është me rëndësi, është që këto obligime financiare në procedurë të përsëritur janë përfunduar, pra janë kryer në procedurë të rregullt administrative. Bordi i ri ka filluar të punojë javën që shkoi, nesër e ka mbledhjen e dytë dhe do të përfundohen edhe të gjitha ato obligime që i kemi pasur ndaj Diellzës, në procedurë të rregullt administrative, tash brenda javëve të cilat vijnë, sepse është një kohë e cila kërkon derisa të liferohen mjetet financiare nga kontoja e Ministrisë së Shëndetësisë deri në institucionin shëndetësor, ku është duke u kryer shërimi.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që disa çështje janë më shumë për në Komision, kur do të thirrej ministri dhe ndoshta më shumë i takojnë Avokatit të Popullit, se sa që po ngritën në Parlament, por sidoqoftë kështu e kemi filluar dhe kështu do të vazhdojë.

Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Ibrahim Makolli. Ministri nuk është këtu. A e doni fjalën?

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Pasi që pyetjes nuk i humb aktualiteti edhe për seancën tjetër, unë kërkoj që kjo pyetje të bartet që të përgjigjet ministri, kur do të jetë i pranishëm një ditë, në seancat e radhës në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

**3. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për debat parlamentar, lidhur me mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për pagat e punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj**

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në bazë të nenit 15, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar mbajtjen e një debati parlamentar lidhur me mosekzekutimin e vendimit të rastit nr. KI-08/09 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për pagat e punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj.

Sipas Rregullores fjalën e ka iniciuesi i kërkesës, zoti Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, si propozues i çështjes.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Tekstin e kërkesës sonë për këtë debat parlamentar e keni dhe unë atë pjesë nuk do ta lexoj, sepse do ta lë në fund, kur të vijë për propozim për rekomandimin që e kemi.

Më lejoni të mundohem, që në mënyrë kronologjike, për aq sa na premtim edhe koha, që t'i them disa fjalë se si ka rrjedhur çështja e këtij problemi, që ka të bëjë me mosekzekutimin e të gjitha aktgjykimëve ose të gjitha shkallëve të mundshme të gjykatave tona e që ka të bëjë me punëtorët e Fabrikës së Tubave dhe Çelikut në Ferizaj.

Unë sa kam informata, qenkan edhe përfaqësuesit e punëtorëve këtu dhe më lejoni t'i përshëndes.

Që nga 27 shkurti i vitit '90, kur menaxhmenti i atëhershëm ka larguar nga puna këta punëtorë, gjegjësisht u ka shkëputur kontratën, vazhdon odisejada e këtyre punëtorëve dhe fatkeqësisht edhe të shumë tjerëve, por në këtë rast do të flasim konkretisht për punëtorët e Fabrikës së Tubave dhe të Çelikut në Ferizaj.

Në atë kohë, menjëherë këta punëtorë janë ankuar në Gjykatën e atëhershme të Punës së Bashkuar dhe pas luftës ajo gjykatë është shuar dhe kërkesat, gjegjësisht punëtorët iu kanë drejtuar Gjykatës Komunale në Ferizaj me kërkesë-padi lidhur me shkaktimin e humbjeve dhe kompensimin e pagave.

Më 11 janar të vitit 2002, Gjykata Komunale në Ferizaj ka vlerësuar këtë kërkesë-padi si të arsyeshme dhe si të bazuar dhe konform kësaj, është pranuar kërkesa e tyre për kompensim.

Më 20 mars 2002, Bordi ekzekutiv i ish-IMK-së vendosi ta aprovojë kërkesën e punëtorëve për përmbarimin e vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe t'i rikthejë punonjësit në pozitat e tyre, në pajtim me aktgjykimin.

Po ashtu, më 22 dhjetor 2005, Gjykata Komunale në Ferizaj, lejoi përmbarimin e këtij aktgjykimi të 11 janarit 2002, duke ndaluar kështu privatizimin e kësaj fabrike nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Më 16 janar 2006, në Gjykatën Komunale të Ferizajt, u mor vendim sipas detyrës zyrtare, gjegjësisht një gjyqtar, që të lejojë përmbarimin e vendimit të 22 dhjetorit 2005, për këta punëtorë.

Për pagesë të rrogave të 912 punonjësve, në shumë prej 25 649 250 euro, si dhe me kamatë vjetore prej 3%, duke llogaritur që nga 13 marsi 2002.

Duke dëshiruar që t'u lë të tjerëve hapësirë, po mundohem që jo të gjitha këto në pikat që po i përmend t'i them deri në fund, sepse secila prej tyre ka edhe më gjerësisht të dhëna.

Më 25 mars 2006, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e refuzoi kërkesën e punonjësve për ta ndaluar privatizimin e kësaj fabrike, por e vërtetoi aktvendimin e gjyqtarit të Gjykatës Komunale të 16 janarit 2006, për lejimin e përmbarimit të kërkesës së tyre të plotë, në lidhje me rrogat e papaguara dhe ripunësimin e tyre.

Në prill 2006 AKM-ja, tash AKP-ja, por atëherë AKM-ja parashtroi padi në kapacitetin e vet si palë e tretë në Gjykatën Komunale në Ferizaj, duke kërkuar që të shpallet vendimi gjyqësor për përmbarim si i papranueshëm.

Më 17 maj 2006, Gjykata Komunale në Ferizaj vendosi të shtyjë ekzekutimin dhe t'i lejojë AKM-së si palë e tretë në procedurë parashtrimin brenda 30 ditësh, nga pranimi i aktgjykimit në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për të sfiduar aktvendimin për përmbarim.

Më 14 qershor 2006 AKM-ja ka kërkuar nga Gjykata Komunale në Ferizaj që ta shtyjë përmbarimin e përcaktuar me urdhrin gjyqësor të datës 16 janar 2006 deri në përfundimin e procedurave gjyqësore.

Më 2 gusht 2006 AKM-ja parashtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Më 9 gusht 2006, Dhoma e Posaçme e refuzoi ankesën e AKM-së.

Më 11 dhjetor 2006, Gjykata Komunale Ferizaj i ngriu asetet financiare të kësaj fabrike, duke obliguar AKM-në, që t'ua paguajë punëtorëve shumën prej, që e thash më herët 25.649.250 euro, nga asetet e kësaj fabrike.

Më 14 qershor 2007, Gjykata Supreme duke vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori publik i shtetit anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 2006-ës dhe e ktheu rastin për rishqyrtim në atë gjykatë.

Më 20 nëntor 2007, Policia Speciale uzurpoi këtë fabrikë dhe ua ndaloi punëtorëve vazhdimin e punës.

Më 21 nëntor 2007 AKM-ja publikisht deklaroi se IMK është privatizuar në tërësi për shumën prej 3 milionë e 200 mijë euro dhe se pronari i ri është zotuar t'i punësojë 360 punëtorë dhe t'i investojë 13.2 milionë euro.

Më 17 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e refuzoi si të pabazuar ankesën e AKM-së kundër vendimit për përmbarim të Gjykatës Komunale të datës 1 dhjetor 2006.

Më 18 dhjetor 2007, Bordi i Drejtorëve i AKM-së e shpalli fabrikën në likuidim, në bazë të nenit 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut. Pas kësaj punëtorët ia paraqitën kërkesat e tyre kreditore Komisionit për Likuidime.

Më 10 mars 2008, punëtorët i kërkuan Gjykatës Komunale në Ferizaj, që ta anulojë kontratën e shitësit dhe të blerësit mes IKM-së dhe AKM-së.

Më 9 gusht 2008 Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Persona të Pagjetur, Barazi Gjinore, në fund të diskutimit që e kanë pasur, kanë vlerësuar se binte brenda mandatit të këtij Komisioni, si dhe kishte theksuar dhe kërkuar që aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj kishte bazë ligjore dhe si Komision kanë rekomanduar aplikimin, gjegjësisht ekzekutimin e këtij aktgjykimi, ose të këtyre aktgjykimeve.

Më 6 tetor 2008, Gjykata Komunale në Ferizaj ex officio ka ndaluar ekzekutimin pas një njoftimi dërguar nga AKM-ja, që kjo fabrikë është futur në procesin e likuidimit. Punëtorët nuk ishin ankuar, sepse nuk ishin njoftuar për vendimin në fjalë. Do të thotë, nuk kanë qenë fare të njoftuar, që është një shkelje edhe në këtë rast, e të drejtave të tyre.

Më 26 shkurt 2009, punonjësit e përfaqësuar nga parashtruesit e kërkesave, dorëzuan kërkesën për përmbarim në Gjykatën Kushtetuese dhe kjo gjykatë më 3 mars 2009, njoftoi parashtruesit, se kërkesa është regjistruar në gjykatë.

Ky parashtrues, domethënë Sindikata e punëtorët, kanë përfaqësuar dhe përfaqësojnë 912 punëtorë, pretendimet e të cilëve kundër punëdhënësit të tyre, janë vërtetuar nga gjykata, qysh prej vitit 2002 e këtej.

Kur aktgjykimi i 11 janarit 2002 u bë rex judikata, në terminologjinë juridike, më 11 mars 2002, punëtorët do të duheshin trajtuar si kreditorë, pasi që padia e tyre ishte miratuar. Gjykata vëren që më 11 janar 2002 Gjykata Komunale ka vlerësuar pretendimet e parashtruesve në bazë të dispozitave relevante të Ligjit mbi procedurën kontestimore, si dhe ka vendosur që padia është e bazuar. Megjithatë, deri më sot, afër 11 vjet pas vendimit dhe 7 vjet pas vendimit për ekzekutim, aktgjykimi ende nuk është zbatuar.

Në të gjitha këto rrethana të konstatuara, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në vendimin e saj të 17 dhjetorit 2010, i pranon këto kërkesa, gjegjësisht e konsideron që vendimi i Gjykatës Komunale dhe të gjitha vendimet e gjykatave tjera, kanë bazë dhe duhen ekzekutuar, sepse është shkelur e drejta elementare e këtyre punëtorëve dhe kjo është bërë, po e them, ky vendim është marrë njëzëri.

Të nderuar kolegë, si parti institucionaliste, po edhe parti tjera, si deputetë, ne kemi obligim, që vendimet e gjykatave përkatëse të kërkojmë që të ekzekutohen. Dhe, më lejoni që shumë shkurt të ju them që këtu janë një mori vendimesh, që nga ai që është i Gjykatës Komunale të Ferizajt, i vitit 2001, është aktvendimi për ekzekutim i vitit 2005, është refuzimi i ankesës së AKM-së nga ana e Gjykatës ose dhomës speciale, po ashtu kjo është e vitit 2008. Po ashtu, është Gjykata e Qarkut aktvendimi që e ka refuzuar ankesën e AKM-së, që e thash më herët.

Është vendimi i 17 dhjetorit 2010 i Gjykatës Kushtetuese, që është instanca e fundit, e cila vlerëson ligjshmërinë, gjegjësisht kushtetutshmërinë e aktvendimeve ose aktgjykimeve të ndryshme.

Më lejoni të lexoj këtë që e thotë Gjykata Kushtetuese, sepse është nëse mund të thuhet, finalizuesi i gjithë kësaj odisejade, që e kanë këta punëtorë.

Mbi të gjitha, kjo gjykatë kërkesën e punëtorëve e konsideron të pranueshme. Konsideron që ka pasur shkelje të nenit 31, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 e drejta për gjykim të drejtë dhe nenit 13 e drejta për zgjidhje efektive të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

Konsideron që vendimi final dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të ekzekutohet nga autoritetet kompetente në veçanti nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhës ligjor i AKM-së.

Konsideron se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të dorëzojë në Gjykatë, brenda një periudhe...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Edhe dy minuta, në emër të Grupit.

ISMET BEQIRI: Do të thotë, është dhënë atëherë, më 17 dhjetor 2010, afat gjashtëmuor, po e tërheq vëmendjen, që të ndërmerren masa për ekzekutimin e këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim do t'u komunikohet palëve: Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Qeverisë.

Në pajtim me nenin 20.4 të ligjit, ky aktgjykim do të publikohet në Gazetën Zyrtare. Aktgjykimi hyn në fuqi menjëherë si dhe mund t'i nënshtrohet korrigjimit redaktues.

Ky është, domethënë arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës së 17 dhjetorit 2007. Ndërkohë, është kërkuar sqarim nga Gjykata Kushtetuese. E ka bërë sqarimin dhe e ka mbështetë përsëri aktgjykimin e mëhershëm. Sqarimi është bërë më 12 maj 2011.

Kjo është letra, që i është dërguar nga Gjykata Kushtetuese më 4 tetor 2011 kryeministrit të vendit, zotit Thaçi, që të ndërmarrë masa për ekzekutimin e këtij aktgjykimi ose këtyre aktgjytimeve.

Po ashtu, këtu është përsëritje edhe një herë e një shkrese, më 23 korrik 2012, që i është dërguar zotit Thaçi dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe në fund e keni vendimin për publikim të mospërmbarimit të këtij vendimi, që është obligim ligjor dhe kjo është e datës 14 nëntor 2012.

Dhe, fare në fund po e lexoj çfarë thuhet: Të publikojë vendimin për mospërmbarim, për shkak se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit në Kosovë, ende nuk kanë përmbushur aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI-08/09, të 17 dhjetorit 2010. Ky vendim do t'u komunikohet palëve, Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Qeverisë.

Në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, për qëllime të rregullës 36/6 të Rregullores së punës, ky vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare.

Të nderuar kolegë deputetë, vetë mospërmbarimi ex officio do të duhej të shkaktonte edhe një pasojë, e cila është ajo e ngritjes së kallëzimit penal dhe të dhënies së përgjegjësisë, pse nuk ekzekutohet një vendim ose shumë vendime të gjykatave tona kompetente?

Nëse ne thirrëmi, e si deputetë, si institucione që jemi, për zbatim të ligjit, për zbatim të vendimeve gjyqësore, për sundim vazhdimisht gojën plotë e kemi, të ligjit, atëherë, kolegë të nderuar, ky Kuvend mendoj në fund do ta them këtë mbas debatit, të vetmin rekomandim që e kemi, por që do ta vlerësoj atëherë, ne jemi të obliguar që të insistojmë që vendimet gjyqësore, në këtë rast kemi të bëjmë me mbrojtjen e një vendimi gjyqësor, nga ky Parlament të ekzekutohen. Në të kundërtën, dalim të tillë që po i ekzekutojmë vendimet gjyqësore në mënyrë selektive. Ato që i konvenojnë diku i ekzekutojnë, sepse thonë - ka thënë Gjykata Kushtetuese, ka marrë vendim Gjykata Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese për të gjitha ato vendime që ka marrë, atëherë duhet të respektohet për të gjitha ato vendime dhe jo të bëhet në mënyrë selektive dhe t'u shkelen të drejtat elementare, në këtë rast të punëtorëve.

Për ne vendimi i Gjykatës është i ligjshëm, sepse është vendim i një organi të pavarur. Prandaj, ne e mbështetim absolutisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të instancave tjera dhe kërkojmë që kjo të realizohet dhe në fund, zoti kryesues, besoj që do të ma lejoni mundësinë që të paraqes edhe rekomandimin në fund të debatit, sigurisht edhe në konsultimet që i kemi bërë edhe me kolegët edhe të partive tjera të opozitës, veçmas.

**KRYESUESI:** Është obligim. Faleminderit! Qeveria nuk është. Radha është e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSHIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nenkryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar përfaqësues të Fabrikës së Tubave të Çelikut të Ferizajt,

Më lejoni të prezantoj qëndrimin e Partisë Demokratike të Kosovës, ne e kemi marrë shumë seriozisht këtë kërkesë, kemi bërë një studim dhe analizë ligjore.

Në emër të Grupit Parlamentar, unë jam ngarkuar për një studim ligjor dhe më lejoni të prezantoj qëndrimin e Partisë Demokratike. Nuk do lexoj shkresa, sepse ka mjaftë shkresa, e kam studiuar mirë rastin dhe më lejoni t'i propozoj disa konkluzione, që ne i kemi si grup parlamentar. Ne edhe e kemi takuar përfaqësuesit, por gjithashtu edhe deputetët tonë të zonës kanë qenë vazhdimisht në kontakt dhe i kanë ndihmuar përfaqësuesit në parashtrimin e kësaj kërkesë.

Në kushte normale, në kushtet e funksionimit të mirëfilltë të shtetit ligjor, për një kërkesë të tillë nuk do debatonte Parlamenti, sepse pushtetet janë të ndara dhe vendimet e gjykatave duhet ex officio të realizohen dhe ata që nuk realizojnë duhet të kenë sanksione apo masa adekuate.

Por, me qenë se jemi në filltet e ndërtimit të shtetit ligjor, lejohet nganjëherë që edhe Parlamenti të diskutojë për një temë, siç është ekzekutimi i vendimeve të gjykatave, që do të duhej të funksiononte pa ndërhyrje të Parlamentit, sepse në disa raport ndërkombëtare, kjo mund të regjistrohet edhe si ndeshje e pushteteve apo thyerje e parimit të ndarjes së pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

Konkluzioni i parë i PDK-së është që kërkesa është krejtësisht e ligjshme. Bëhet fjalë për të drejtat legjitime të punëtorëve dhe këta punëtorë kanë ndarë fatin e qindra, mijëra punëtorëve të larguar padrejtësisht nga puna. Por, fatkeqësisht, jo të gjithë i kanë përdorur mjetet juridike, për realizimin e të drejtave të punës dhe rasti i punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut është një rast i mirë i procedimit ligjor, sepse këta punëtorë në afatet kohore kanë parashtruar kërkesa, kanë hapur çështjen në Gjykatën Komunale të Ferizajt dhe e kanë fituar kontestin dhe të drejtat e punës, qoftë të drejtën e rikthimit në punë, qoftë të drejtën e kompensimit.

Gjithashtu, ky vendim pastaj në rrugë ligjore është bërë i plotfuqishëm dhe nuk do të duhej të kërkohej ndihma e Gjykatës Kushtetuese për përmbarim, sepse vetë sistemi i gjykatave të rregullta do të duhej ta mundësonte përmbarimin.

Të gjitha veprimet, që janë ndërmarrë pastaj, kanë shkuar në rrugë ligjore deri te kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, për përmbarim. Për ne, problemi kryesor ka qenë te mosefikasiteti i Agjencisë Kosovare atëherë të Mirëbesimit, e cila përkundër një vendimi të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale, e ka futur në proces të likuidimit dhe e ka futur në proces të privatizimit, duke e injoruar të drejtat e punëtorëve dhe duke mos i ftuar ata në seancat e likuidimit, në cilësinë e debitorit, apo në cilësinë e atyre që kanë parashtrësia dhe i kanë të drejtat e fituara me ligj.

Mendoj, se procesi i privatizimit nuk është dashur të ndodhë derisa nuk janë kryer obligimet edhe financiare, pra nuk janë paguar pagat e punëtorëve dhe nuk janë realizuar të drejtat. Por, fatkeqësisht atëherë kjo Agjenci është qeverisur kryesisht, me rregullore të UNMIK-ut. UNMIK-u ka pasur ndikim të madh, e si duket UNMIK-u nuk e ka pranuar as legjitimitetin e Gjykatës Komunale në Ferizaj. Si duket e ka injoruar një vendim të një gjykate legjitime, të cilën vetë e ka ndërtuar në periudhën e pasluftës dhe e ka futur në një proces të privatizimit, duke mos i zhvilluar veprimet që janë paraparë me ligjet dhe rregulloret në fuqi për procesin e likuidimit.

Kur një ndërmarrje likuidohet apo përgatitet për privatizim, bëhet studimi i fizibilitetit të gjendjes së saj financiare, bëhet aktiva dhe pasiva e asaj ndërmarrjes dhe në një mënyrë këta punëtorë kanë qenë debitorë dhe kërkues dhe kanë pasur të drejta. Dhe, çfarë ka ndodhur, ata e marrin një status të aksionarëve të kësaj ndërmarrjeje, duke mos pasur mjete financiare për t'u kompensuar, këta vendosen të kompensohen me sende, por edhe sendet kanë qenë të pamjaftueshme dhe u jepet statusi i aksionarit të ndërmarrjes, gjë që nuk është respektuar pastaj në procedurën e privatizimit.

Drejtimi i tyre tek Gjykata Kushtetuese ka ardhur si pasojë e kësaj loje ligjore që është bërë, apo ndërhyrjes së UNMIK-ut dhe ata është dashur të ridrejtohen. Absolutisht, nuk mund të diskutojmë karakterin detyrues të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ju e dini që unë kam qenë ndër më kritikët ndaj disa vendimeve edhe më kritik edhe se opozita, që është ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por Kushtetuta ia ka dhënë fuqinë detyruese dhe nuk mund të vëmë në pyetje efektin detyrues të vendimeve të gjykatës.

Mirëpo, duhet të jemi jashtëzakonisht racional se si ta realizojmë këtë kërkesë të punëtorëve, në mënyrë që kjo kërkesë të hyjë në proces të realizimit, jo në proces të debateve politike, apo të partive politike, po ne jemi të interesuar si Parlament, se pas këtij debati kjo kërkesë të realizohet.

Cila është rruga më e mirë e realizimit? Cilat janë mundësitë reale të realizimit, sepse është vonuar kërkesa, nuk është realizuar me kohë?

Unë mendoj, se atëherë ka pasur mundësi me kohë të realizohet, pra 2006-a ka qenë koha optimale e realizimit, sepse vendimi është i plotfuqishëm, është lëshuar vendimi për përmbarim nga Gjykata Komunale e Ferizajt, dhe atëherë është dashur të realizohet. Rruga e vetme, që ne si deputetë mund të bëjmë presion për implementimin e këtyre kërkesave, është që të kërkojmë te Agjencia Kosovare e Privatizimit, që është trashëgimtare e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, që ajo t'i gjejë mekanizmat e dëmshpërblimit dhe kompensimit të këtyre punëtorëve.

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka fonde mjaft të mëdha, ka fonde që nuk iu kanë kthyer ekonomisë së Kosovës, po fatkeqësisht ato fonde, ndoshta janë objekt, me të cilin bankat ndërkombëtare fitojnë interesa apo profite financiare. Ne duhet ta nxjerrim një konkluzion të vetëm, që të kërkojmë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit t'i gjejë modalitetet në një afat të caktuar, mund t'ia caktojmë afatin tremujor, gjashtëmujor, t'i gjejë modalitetet dhe ato modalitete t'i bëjë publike, për kompensimin e këtyre

punëtorëve. Dhe, jo vetëm këtyre punëtorëve, por edhe punëtorëve tjerë, që kanë fituar kontestet ligjore.

Në mungesë të kulturës ligjore në Kosovë, shumë punëtorë kanë pësuar duke mos ndjekur mjetet juridike, mjetet ligjore, që nuk është rasti me punëtorët e Fabrikës së Tubave të Çelikut, që kanë proceduar me kohë e kanë fituar kontestin dhe tash ata, qoftë te drejtësia vendore, qoftë te drejtësia ndërkombëtare, do t'i fitojnë edhe të drejtat, që rrjedhin nga ai kontest.

Ne duhet në konkluzionet që do t'i bëjmë bashkë pas përfundimit të debatit, ku Partia Demokratike do të jetë shumë konstruktive dhe do të marrim pjesë, ne do të ndërtojmë konkluzionet që e implementojnë këtë vendim, e jo që e lënë pezull, sepse pezull ka qëndruar mjaft.

Më së paku Qeveria aktuale është e involvuar në këtë, sepse kjo çështje nëse ka pasur vullnet, është dashur të zgjidhet në Qeverinë e vitit 2005 - 2006, është dashur të zgjidhet atëherë. Tani Qeveria nuk mund të jetë implementuese. Implementues mund të jetë Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe ne mendojmë që duhet t'i japim mbështetje kërkesës dhe kërkojmë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, që ajo nuk i dimë si deputetë mundësitë nga cilat pozicione, nga cilat fonde, si do të realizohet kjo, po ne kemi të drejtë si Kuvend për ta mbështetur një kërkesë të qytetarëve, sepse ne jemi institucion...

Dhe, ne mund të nxjerrim një rekomandim, që brenda tre muajve Agjencia Kosovare e Privatizimit të fillojë implementimin e kësaj kërkesë dhe kemi të drejtë të kërkojmë informatë nga kjo Agjenci, a ka filluar të realizohet konkluzioni që e sjellim ne si Kuvend.

Urojmë, që në rastet tjera të mos kemi debate për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, sepse ndërhyjmë në gjyqësor. Gjyqësori është pushtet i tretë dhe Parlamentit i lejohet...

*(Ndërhyrje)*

...ne mund të diskutojmë, po për problemet e funksionimit të përgjithshëm gjyqësor, profesor, ju jeni institucionalit, ndoshta jeni doajen i qëndrimit institucional. Por, jo, nuk është mirë për një shtet, që Parlamenti të diskutojë për ekzekutimin e organeve gjyqësore... Parlamenti flet, por Parlamenti nganjëherë duke folur bën edhe dëm.

Kështu që, po e përfundoj, Partia Demokratike e Kosovës e mbështet këtë kërkesë, ka mirëkuptim për këtë kërkesë. Ne e kemi marrë shumë seriozisht këtë kërkesë dhe ne, jo vetëm në Parlament, por do ta përdorim autoritetin si parti që të implementohet dhe dëshirojmë të marrim sa më shpejt informata që kërkesa legjitime dhe e ligjshme e punëtorëve ka filluar të implementohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ne si subjekt politik e kemi shtruar këtë çështje shumë herë në Kuvend, mirëpo fatkeqësisht deri më tash nuk është ndërmarrë asgjë.

Është shumë e qartë që po ta kishim një Qeveri të përgjegjshme, sigurisht që kjo çështje nuk do të vinte fare në Kuvend, pra nuk do të duhej të debatohej fare në Kuvend. Por, fatkeqësisht, përveç skandaleve të tjera, e kemi një Qeveri dhe Agjencinë e Privatizimit që po i shpërfillin vendimet e Gjykatës Kushtetuese, madje kjo Qeveri aplikon standarde të dyfishta, duke i zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese vetëm kur ato i konvenojnë.

Ish-punëtorët e Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj, në vitin 2001, patën ushtruar padi në Gjykatën Komunale të Ferizajt që të vërtetohet largimi i tyre i dhunshëm nga puna prej forcave serbe në vitin 1990.

Në vitin 2002, Gjykata Komunale vendosi që ish-punëtorëve t’ua njohë padrejtësinë e largimit të dhunshëm nga vendi i punës, nga forcat serbe në vitin 1990, dhe t’ua kompensojë të gjitha të ardhurat mujore prej kur ata u larguan nga puna.

Ky aktvendim, e që ishte i formës së prerë, nuk u zbatua nga Fabrika e Tubave të Çelikut, për më tepër në valën e 19-të të privatizimit, AKM-ja në atë kohë e bëri shitjen e Fabrikës së Tubave të Çelikut me një çmim skandaloz prej vetëm 3 675 000 euro, akoma pa u kryer obligimet financiare ndaj punëtorëve. Pra, me privatizimin e Fabrikës së Tubave të Çelikut u shkel edhe aktvendimi i Gjykatës Komunale të Ferizajt.

Më tej, punëtorët e ushtruan edhe një padi për vlerësimin e borxhit në Gjykatën Komunale në Ferizaj, dhe në bazë të aktvendimit të vitit 2006, kjo gjykatë e definoi borxhin prej 25 659 000 euro. Ky aktvendim madje thotë që nëse rrezikohet borxhi, debitori, pra AKM-ja, ua ka kreditorëve të gjitha asetet e luajtshme, që duhet të shiten dhe borxhi i kreditorëve, pra punëtorëve, duhet t’u paguhet. AKM-ja në atë kohë e ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, por kjo e fundit e hodhi poshtë atë ankesë si të pabazë dhe e vërtetoi aktvendimin e Gjykatës, pra për kthimin e borxhit të kreditorëve.

Të nderuar deputetë,

Dëmet e privatizimit në Kosovë janë shumë të mëdha. Privatizimi deri më tani e ka rrënuar ekonominë dhe e ka rritur papunësinë, e vetëm me privatizimin e Fabrikës së Tubave të Çelikut u larguan nga puna 647 punëtorë dhe kjo e solli një organizim të fuqishëm të punëtorëve. Pra, edhe përkundër vështirësive e pengesave që patën nga klanet e ndryshme, Sindikata bëri që ata ta dërgojnë një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, më 3 mars 2009, në lidhje me vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt.

Dhe, më 17 dhjetor 2010, Gjykata Kushtetuese nxori aktgjykim, më anë të të cilit e shpalli kërkesën e pranueshme, madje konsideroi që ka pasur shkelje të Kushtetutës, pra të nenit 31 “E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm”; gjithashtu shkelje të nenit 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përveç kësaj, Gjykata konsideroi që vendimi final i Gjykatës Komunale në Ferizaj është i detyrueshëm dhe duhet të ekzekutohet nga autoritetet kompetente, e autoritetet kompetente janë Qeverinë dhe Agjencia e Privatizimit.

Madje kërkon nga Qeveria dhe AKP-ja që në afat prej 6 muajsh të japin informata në lidhje me masat e ndërmarra për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Pas kësaj, AKP-ja kërkon sqarim nga Gjykata Kushtetuese se cilat janë detyrimet konkrete të AKP-së dhe Gjykata përsëri nxjerr aktgjykim me anë të të cilit ia shpjegon AKP-së se cilat janë detyrimet e saj, duke ia sqaruar edhe një herë që aktvendimi i datës 11 janar 2002 është i detyrueshëm për ekzekutim.

Madje, në pikën 10 të këtij aktgjykimi, Gjykata sqaron shumë qartë se ku duhet të merren mjetet për kthimin e borxhit. Pra, borxhi duhet të kthehet nga mjetet e realizuara nga administrimi, shitja, transferimi ose likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore.

Gjykata Kushtetuese, më 4 tetor 2011, i ka dërguar një shkresë kryeministrit Hashim Thaçi dhe AKP-së, me të cilën ua përkujton se aktgjykim i datës 17 dhjetor 2010 duhet të zbatohet nga autoritetet kompetente, pra nga vetë Qeveria dhe AKP-ja.

Dhe e fton Qeverinë dhe AKP që t'i binden këtij aktgjykimi, sa më parë të jetë e mundur, por jo më vonë se data 17 dhjetor 2011.

Sot jemi më 21 shkurt 2013, pra janë bërë 11 vjet prej kur po vazhdojnë të shkelen të drejtat e punëtorëve, e as Qeveria, e as AKP-aj nuk e kanë ndërmarrë asnjë veprim deri më tani.

Ne sigurisht që do ta mbështetim rekomandimin e LDK-së, edhe pse mendojmë që ndoshta është dashur të afatizohet, në mënyrë që të ketë efekt, apo fuqi më të madhe.

Dhe, në fund, i bëjmë thirrje Qeverisë dhe AKP-së që ta ndërpresë shkeljen e të drejtave të punëtorëve dhe ta ndërpresë shkeljen e Kushtetutës, pra nenin 116, i cili thotë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për Gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Mendoj se është totalisht e panevojshme të përsëriten të gjitha argumentet të cilat u thanë këtu, domethënë të gjitha argumentet ligjore që u përmendën nga kolegët parafolës.

Por, mendoj se e kemi më shumë se vetëm një aspekt këtu. Nuk kemi të bëjmë vetëm me implementimin e një vendimi gjyqësor, që, në fund të fundit, ka shkuar deri në Gjykatën Kushtetuese.

Mendoj se u tha më përpara që moszbatimi i aktvendimeve përbën në vetvete shkelje ligjore dhe mund të kualifikohet edhe si vepër penale. E kjo që ka ndodhur me këta punëtorë është shkelje e shumëfishtë, do të thotë disa herë është përsëritur shkelja. Nuk është shkelur vetëm një herë, e ne po merremi me një vendim, i cili nuk është implementuar.

Për t'i rënë shumë shkurt, Aleanca mendon se institucionalizmi kërkon përgjegjësi dhe nuk është e mjaftueshme të arrihet vetëm deri te pagesa e gjithë asaj që është e ligjshme për punëtorët, e që shihet se është e ligjshme, do të thotë edhe me vendime gati të të gjitha instancave gjyqësore.

Është po ashtu e nevojshme që Kuvendi sot në rekomandimet e veta t'i bëjë thirrje Prokurorisë që t'i hetojë të gjithë ata që e kanë shkelur ligjin në vazhdimësi.

E dimë ne këtu se Legjislativi nuk ka të drejtë të ndërhyjë në punën e Gjyqësorit. Mirëpo, ky Legjislativ është përfaqësues i popullit, domethënë jemi përfaqësues të popullit, dhe kemi të drejtë të bëjmë thirrje edhe për institucionet gjyqësore që të merren me çështje, të cilat ne këtu po i konsiderojmë që janë shkelje, jo vetëm e të drejtave të punëtorëve dhe të drejtave të njeriut, por shkelje flagrante e ligjit dhe çdo procedure, të cilën e kemi ndërtuar në Kosovë.

Edhe një herë po e përsëris - Aleanca insiston që përpos që duhet të implementohet vendimi, duhet të gjendet përgjegjësia pse nuk është implementuar deri më tani. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët,

Përshëndetje për punëtorët e Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj që gjenden sot në këtë seancë plenare,

Duke marrë parasysh arsyetimin e çështjes së thirrjes së kësaj seance për vendimin e rastit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për pagat e punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj, mund të themi se në bazë të Kushtetutës, Ekzekutivi, Legjislativi dhe Gjyqësori janë të ndarë në Kosovë.

Me sa po më duket, deputetët nuk janë të interesuar për debat, janë të interesuar të bisedojnë!

Dhe, në rast se e shohim mosekzekutimin e vendimit të Gjykatës në Ferizaj dhe të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, atëherë mund të themi se e gjithë esenca qëndron që vendimet e gjykatës nuk mund të debatohen në Kuvendin e Kosovës, se këtu është vendi ku nxirren ligjet, e jo të debatohen vendimet e gjykatës.

Ndërsa çështja se çka mund t'u ndihmojmë këtyre punëtorëve, në bazë të Ligjit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duhet të kërkojmë nga kjo agjenci, e cila i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, që t'i ekzekutojë vendimet të cilat i vijnë nga gjykata. Kërkesat e punëtorëve duhet të merren parasysh në Agjencinë Kosovare të Privatizimit edhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është radha e deputetëve. Deputetja Lumnije Morina e ka fjalën.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj, Pas përfundimit të luftës, ekonomia e Kosovës ishte në një gjendje të mjerueshme, si pasojë e politikës shtypëse dhe shfrytëzuese të ish-Jugosllavisë dhe Serbisë ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj, e cila gjendje përfundoi me pasoja shkatërruese gjatë luftës.

Në vitet e '90-ta, largimi masiv nga puna i punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, i punëtorëve të arsimit, punëtorëve të shëndetësisë, të kulturës, të administratës shtetërore e rënduan tej mase gjendjen ekonomike sociale, arsimore, shëndetësore e kulturore të shqiptarëve.

Lufta e gjeti Kosovën në një gjendje tepër të rëndë në të gjitha sferat e jetës. Humbjet ishin shumë të mëdha.

Pas luftës, shpresat e qytetarëve të Kosovës për zhvillim ekonomik dhe zbutje të gjendjes së rëndë ekonomike ishin orientuar, ndër të tjera, edhe te procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore filloi në vitin 2001, ndërkaq pritjet e qytetarëve nga ky proces ishin të mëdha. Gjatë këtij procesi, i cili ishte i ndërlikuar dhe në shpërputhje me pritjet e qytetarëve, disa kanë mundur të përfitojnë diçka, ndërsa të tjerët pothuajse asgjë.

Nëpër procesin e privatizimit kaloi edhe Fabrika e Tubave të Çelikut IMK e Ferizajt, me gjithë faktin se punëtorët kishin parashtruar kërkesë-padi ndaj menaxhmentit të përkohshëm të fabrikës lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës, me arsyetimin se kanë munguar në punë, si dhe për kompensimin e pagave të 912 punëtorëve të larguar nga puna në mënyrë të dhunshme, më 27 shkurt të vitit 1990.

Konsideroj se kompensimin e pagave të të gjithë atyre që u larguan në mënyrë të dhunshme nga puna, punëtorëve të fabrikave, të shëndetësisë, punëtorëve të arsimit, punëtorëve të administratës, të kulturës e të tjerë, duhet ta bëjë Serbia dhe ky problem do të duhej të shtrohej në bisedimet Kosovë-Serbi, sepse Serbia është shkaktare dhe përgjegjëse për largimin e punëtorëve nga puna dhe kjo është arsyeja se pse nuk duhet kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të bëjë kompensimin për diçka që nuk është shkaktare dhe as përgjegjëse.

Kërkesa për kompensim e punëtorëve të larguar nga puna u bë nga Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK Ferizaj dhe u miratua nga Gjykata Komunale në Ferizaj në vitin 2001, por nuk u ekzekutua asnjëherë.

Meqenëse vendimi i Gjykatës Komunale nuk është ekzekutuar asnjëherë dhe Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK Ferizaj ishin këmbëngulës në realizimin e vendimit, ata iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vlerësimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale të Ferizajt dhe Gjykata Kushtetuese e shpalli si të pranueshme kërkesën e punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut IMK të Ferizajt.

Konsideroj që problemi i punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut të Ferizajt duhet të zgjidhet përfundimisht, në mënyrë që punëtorët të mos bredhin edhe më tutje poshtë e lart për realizimin e vendimeve që janë marrë nga gjykata në favor të tyre.

Cila do të jetë mënyra e realizimit të kërkesës së këtyre punëtorëve dhe nga kush, nga Qeveria e Republikës së Kosovës apo nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, unë mendoj se adresa dhe zgjidhja më e arsyeshme dhe më e drejtë e këtij problemi është Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhëse ligjore e AKM-së, që nëpërmjet fondit të mirëbesimit t'i japë fund këtij problemi. Pra, të bëjë kompensimin e punëtorëve dhe kështu ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Atëherë unë do të flas shkurt, sepse në mënyrë të detajuar e tha edhe shefi i Grupit tonë Parlamentar. Qëllimi i debatit dhe ajo çka ne synojmë sot, jo vetëm interferimi në çështjet e drejtësisë, është një kërkesë shumë e arsyeshme, shumë ligjore dhe e cila ishte dhe është diskriminuese me moszbatimin e saj.

Ajo që është paraqitur nga Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut duhet të thuhet qartë dhe mënyra si unë e shoh këtë është se ky proces i privatizimit duhet të hetohet në tërësi, jo vetëm si shitje dhe jo vetëm si problem i moskthimit të mjeteve të pronari, që nënkupton punëtorët, por edhe një tendencë e kriminalizimit të aseteve private, siç është edhe kjo pronë shoqërore.

Prandaj, natyra e problemit nuk është vetëm te të drejtat e punëtorëve, por kjo shitje është e paligjshme dhe me të duhet të merret hetuesia. Është e dëmshme, arbitrare dhe në kundërshtim, ashtu siç e kanë thënë, me të gjitha normat ligjore.

Prandaj, arsyeja e cila është paraqitur nga 912 punëtorë duhet të implementohet në formën, e cila është paraqitur, sepse kjo shumë e paraqitur e shitjes së kësaj tregon vetë natyrën inkriminuese të njerëzve në procesin e privatizimit dhe të atyre që e kanë blerë këtë fabrikë dhe sot pretendojnë me këtë formë. Jo vetëm që nuk i kanë realizuar të drejtat minimale të punëtorëve, kthimin e tyre, por as mënyrën e investimeve, që shihet

nga komunikimi që ne kemi pasur edhe me Sindikatën, por edhe nga dokumentacioni i paraqitur.

Prandaj, sot me të drejtë kërkohet ky debat, jo vetëm për arsye ligjore, por edhe për arsye morale dhe të drejta të njeriut në Republikën e Kosovës.

Kjo që po ndodh, kjo praktikë e keqe e mosimplementimit të ligjit në tërësi tregon se cili është niveli dhe cila është logjika, edhe e qeverisjes, por edhe e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila është parë edhe me veprimin e sotëm.

Prandaj, rekomandimi është shumë i qartë dhe shumë konkret. Të drejtat e punëtorëve duhet të realizohen në mënyrën e paraparë me ligj, ashtu siç e ka thënë edhe organi, i cili e ka bërë vlefshmërinë e kushtetutshmërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës duhet t'i sqarojmë së pari dy gjëra.

E para, kërkesa për këtë debat dhe rekomandimet për përfundimin e këtij debati, që ne propozojmë të votohen, assesi nuk janë kërkesa që i drejtohen Gjyqësorit. Janë kërkesa që u drejtohen atyre që po ndërhyjnë në Gjyqësor, prandaj kërkesa jonë për zbatim të vendimeve të Gjyqësorit assesi nuk mund të konsiderohet apo vlerësohet si ndërhyrje në sistemin e drejtësisë.

E dyta, kërkesat që po bëhen që Qeveria e Kosovës si një nga ekzekutuesit e këtij vendimi të largohet nga rekomandimet, është e pabazuar, sepse në qoftë se e bëjmë ne një gjë të tillë, ajo do të jetë në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe, siç u tha, ne nuk mund ta ndryshojmë, e as ta kundërshtojmë një vendim të tillë.

Të nderuar deputetë,

Mosfunksionimi i sistemit gjyqësor është sëmundja më e keqe që mund ta ketë një shtet. As nuk mund të imagjinohet zhvillimi i një shteti në sferat tjera nëse nuk ka ndarje të drejtësisë.

Republika e Kosovës, sipas Kushtetutës së saj, e ushtron autoritetin e saj duke u bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të saj. Prandaj, mosekzekutimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për punëtorët e Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj është, jo vetëm tregues i dështimit të funksionimit kushtetues të shtetit të Kosovës, por është po ashtu dëshmi se Qeveria dhe Agjencia Kosovare për Privatizimin, duke mos e zbatuar këtë vendim, po e shkel të drejtën themelore të mbi 900 punëtorëve të kësaj fabrike. Pra, të drejtën në kompensim të asaj që atyre u takon, të drejtën në kompensim për pronën e tyre dhe të drejtën e tyre në punë.

Të nderuar deputetë,

Sot nuk po flasim vetëm për fatin e 900 punëtorëve, por për fatin e mbi 900 familjeve.

Në fakt, kjo që po diskutojmë ka konotacion edhe më të gjerë, pra ka të bëjë me fatin që po e përcjell tërë sistemin gjyqësor të Kosovës dhe ndërhyrjet politike të njëpasnjëshme që po pranohen e po përmenden edhe nga institucionet ndërkombëtare.

Mungesa e vullnetit politik për t'i zbatuar vendimet e Gjyqësorit sa herë që nuk i shkon për shtati pushtetit, tashmë është bërë praktikë. Ndërhyrjet politike në Gjyqësor, edhe sipas raporteve ndërkombëtare, po e bëjnë këtë sistem jo vetëm të brishtë, por po e çojnë drejt shkatërrimit.

Privatizimi i Fabrikës së Tubave të Çelikut është rast tipik që tregon parregullsitë në procesin e privatizimit. Ka ardhur momenti që interesi i punëtorëve të merret parasysh, e jo vetëm interesi i njerëzve selektivë në numër shumë të vogël, që kanë pasur përfitime të drejtpërdrejta nga ky proces.

Prandaj, Kuvendi si institucioni më i lartë përfaqësues duhet ta ngrejë zërin e vet kundër këtyre veprimeve që nuk janë në përputhje me aktin më të lartë juridik të vendit.

E drejta në gjykim të paanshëm dhe të drejtë duhet t'u sigurohet qytetarëve, përndryshe nuk mund të flasim për sundim të ligjit.

Ka pasur deklarime edhe nga Agjencia për Privatizim se kinse gjykata Kushtetuese nuk ka të drejtë të merret me këtë proces. Është e vërtetë që Gjkata Kushtetuese nuk ka të drejtë të merret me privatizimin, por këtë nuk e ka bërë. Gjkata Kushtetuese është marrë me vlerësimin e respektimit të të drejtave themelore kushtetuese të këtyre punëtorëve dhe në këtë rast ka marrë vendim të drejtë, e ne u bëjmë thirrje institucioneve që atë ta respektojnë.

Të nderuar deputetë,

Duke iu referuar një vendimi të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut, Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese theksojnë një pjesë të atij vendimi që besoj ka nevojë të përsëritet edhe në këtë Kuvend. Po citoj: Duhet të rikujtojmë se sundimi i ligjit, si një nga parimet fundamentale të një shoqërie demokratike, mund të gjendet në të gjitha nenet e Konventës Evropiane. Ai parasupozon respektimin e parimit të sigurisë ligjore, në veçanti sa u përket vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, të cilat janë 'res judicata', apo çështje të gjykuara. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishqyrtim të aktgjykimeve të plotfuqishme e të zbatueshme me qëllim të kërimit të vendosjes së sërishme të rastit. Po të mos ishte kështu, rishqyrtimi i vendimeve të plotfuqishme do të rezultonte me krijimin e një klime të përgjithshme të pasigurisë ligjore, që do ta zbehte besimin e opinionit publik në sistemin juridik, e rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit.

Pra, ajo që kërkojmë ne sot është, as më shumë, e as më pak, sesa zbatimi i një vendimi të plotfuqishëm gjyqësor që ua njeh atyre 912 punëtorëve, e rrjedhimisht e 912 familjeve të Kosovës, të drejtat e tyre kushtetuese.

Përndryshe, nëse ndodh e kundërta, pra nëse Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk e zbatojnë këtë vendim, ashtu siç ka thënë edhe vetë Gjykata Kushtetuese, ata duhet të përballen me përgjegjësi penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonjë e zotërinj,

Në pikën të cilën jemi duke debatuar lidhur me mosrespektimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për punëtorët e Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj është e një rëndësi të veçantë, meqë prek ndjenjat e të gjithë punëtorëve që kanë punuar me vite e vite të tëra aty.

Në këtë fabrikë ka punuar një numër i dukshëm i madh i komuniteteve. Andaj, mosrespektimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese është një shkelje dhe një injorancë e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Në të kundërtën, ne jemi të gjithë të pajtimit të respektohet vendimet e drejtësisë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Unë e mbështes kërkesën e Sindikatës së Punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj që t'u kthehet djersa dhe mundi i tyre që kanë bërë në këtë fabrikë. Konkretisht, kërkoj të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese, t'u kthehen pagat atyre 912 punëtorëve nga Qeveria apo nga AKP-ja.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryesues!

Diskutimin e kësaj teme sot në Kuvend, të nderuar kolegë, e shtroj jo vetëm të arsyeshëm dhe në mbështetje të drejtpërdrejtë të të drejtave dhe interesave të punëtorëve në fjalë, por njëkohësisht edhe si kërkesë e prerë drejtuar autoriteteve tjera shtetërore dhe publike për veprime të përgjegjshme dhe në përputhje me ligjin në të gjitha nivelet, qoftë në ato zbatuese, në organet rishikuese, por edhe në organet tjera mbikëqyrëse.

Praktika e moszbatimit të vendimeve të organeve të ndryshme shtetërore, prej atyre më të larta, siç është Qeveria e Kosovës, tani më nuk është diçka e re dhe e pakuptueshme, ose e papritur për të ndodhur.

Tani, pa hyrë në kronologjinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese lidhur me rastin e Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj, është i rëndësishëm fakti që e kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, i cili e pranoi se 912 punëtorë të Fabrikës së Ferizajt kishin të drejtë në kërkesën e tyre për kompensim, me ç'rast ka konkluduar se është shkelur e drejta e tyre për gjykim të drejtë dhe efektiv, e garantuar me Kushtetutë, sepse autoritetet përkatëse kanë dështuar në përmbartimin e aktgjykimit të formës së prerë.

Gjithashtu, është i rëndësishëm fakti tjetër se Gjykata Kushtetuese taksativisht ka konkluduar se autoritet zbatues i këtij aktgjykimi janë Qeveria dhe AKM-ja, si pasardhëse e AKP-së.

Mendoj që rrallë në vendet e botës ndodh që gjykata të mos i zbatojë vendimet e veta. Kjo është e mundur vetëm në ato sisteme ku ka ndërhyrje politike në Gjyqësor. Në sistemet me gjyqësi të avancuara, moszbatimi i vendimeve të gjykatave dhe zvarritja e përmbartimeve të aktgjykimeve është një vepër penale, ashtu siç është paraparë te ne me Kodin Penal të Kosovës.

Një dukuri tjetër që po zhvillohet në praktikat gjyqësore te ne është fakti i zvarritjes së ekzekutimeve të lëndëve gjyqësore me qëllim të parashkrimit apo vjetërsimit të lëndëve gjyqësore, ose me qëllim të ikjes nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore.

Moszbatimi i vendimeve të tilla, jo vetëm të Gjykatës Kushtetuese për kompensimin e pagave të punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj, po krijon edhe një praktikë të re të keqe, një standard të ri dhe atë ndaj institucionit më të lartë përfundimtar, vendimet e të cilit nuk janë të apelueshme.

Duke u nisur nga praktikat dhe rrethanat e tanishme të funksionimit dhe sundimit të shtetit ligjor, nuk befsohem shumë pse po ndodh kështu, por jam i befasuar me faktin e mosveprimit të Gjykatës Kushtetuese për marrjen e masave ligjore që i ka në kompetencën e saj për moszbatimin e këtij vendimi, përkatësisht për fillimin e procedurës penale ndaj personave përgjegjës për moszbatimin e vendimeve, ashtu siç kërkojnë ligjet pozitive te ne.

Ky mosveprim i organeve zbatuese të ligjit, në fakt, jo vetëm për rastin e Fabrikës së Tubave të Çelikut, por shqetësimi është në rritje se mospërmbartimi po shndërrohet në fenomen, apo në kulturë të punës në të gjitha institucionet tona, jo vetëm të sistemit të drejtësisë.

Në këtë gjendje shoqërore, moszbatimi i ligjit në përmbartimin e vendimeve, që po merr përmasa masive dhe po formësohet si një normë shoqërore, si kulturë institucionale, derisa zbatimi i ligjit për përmbartim është jashtëzakonisht i vështirë, është shumë rrallë i ekzekutuar dhe në procedura të vështira më tepër se në fazën e shqyrtimeve kryesore.

Këtë të vërtetë e ndjejmë kudo. Shkelja dhe respektimi i ligjit ka tendencë të bëhet praktikë e përhapur e kohës tonë. Madje, mospërmbartimi i vendimeve të tilla po bëhet si një mjet i shmangies nga drejtësia dhe si mjet i trajtimeve të privileguara të njerëzve që e shkelin ligjin, apo nuk kanë frikë nga ligji, duke krijuar kështu standarde të dyfishta.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Konsideroj që rekomandimi do të duhej të ishte shumë më decidiv edhe në pikëpamje të përmbushjes së këtij obligimi ligjor të institucioneve zbatuese, duke e përcaktuar taksativisht edhe kohën me të cilën do të duhej të përmbartohej ky vendim sipas aktgjykimit të shpallur nga Gjykata Kushtetuese.

Dhe, krejt në fund, natyrshëm, unë e mbështes këtë rekomandim dhe e mbështes kërkesën e punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Fabrikës së Tubave së Çelikut,

Me interesim të posaçëm e kam lexuar aktgjykimin numër KI-08/09 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të cilin institucion e përgëzoj për një analizë gjithëpërfshirëse të rastit, si dhe për një vendim sa të drejtë, aq edhe profesional.

Nga analiza e të dhënave të prezantuara në aktgjykim mund të vërehet se lidhur me rastin e Fabrikës së Tubave të Çelikut janë shtruar shumë kërkesa, shumë ankesa, pastaj janë marrë shumë vendime, duke filluar nga shkurti i vitit 1990, e deri në dhjetor të vitit 2010. Pra, çështja për të cilën është vendosur në këtë aktgjykim është trajtuar përplot 20 vjet në institucionet e drejtësisë së Kosovës, kurse aktorët involvuar në këtë proces kanë qenë të ndryshëm.

Por, gjithsesi, sipas mendimit tim, vendimet më të drejta i kanë marrë Gjykata Komunale e Ferizajt dhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e cila me aktgjykimin e vet konsideron që vendimi final dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale të Ferizajt duhet të ekzekutohet nga autoritetet kompetente dhe në veçanti nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit si pasardhëse ligjore e AKM-së.

Andaj, si deputet i Kuvendit, duke e vlerësuar këtë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese si plotësisht të drejtë dhe të bazuar në prova dhe në fakte materiale, kërkoj nga autoritetet kompetente të theksuara në aktgjykim që t'i marrin masat konkrete për ekzekutimin e të njëjtit.

Mosekzekutimi i këtij aktgjykimi, por edhe të çdo vendimi tjetër të Gjykatës Kushtetuese paraqet shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, sepse sipas nenit 116, paragrafit 1, të Kushtetutës së Kosovës, thuhet, Citoj: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për Gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”. Po ripërsëris se Kushtetuta parasheh obligimin e këtillë për të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës, që nënkupton edhe për Qeverinë, edhe për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese ka hyrë në fuqi ditën e marrjes së tij, pra më 17 dhjetor 2010, dhe që nga ajo ditë kanë kaluar mbi dy vjet, kurse Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit fare nuk kanë ndërmarrë veprime për ekzekutimin e këtij vendimi, ndonëse decitivisht në aktgjykim parashihet që Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet t'i dorëzojnë në gjykata brenda një periudhe 6-mujore informatat lidhur me masat e ndërmarra për ekzekutimin e këtij aktgjykimi.

Mosndërmarrja e veprimeve nga Qeveria, jo vetëm që paraqet shkelje të dispozitave të Kushtetutës së Kosovës, por paraqet një shembull jo të mirë edhe për organet dhe institucionet tjera të vendit. Po ashtu, paraqet një shembull tipik të mosinteresimit të kësaj Qeverie për interesat ekzistenciale dhe të drejtat themelore të 912 punonjësve kosovarë, si dhe për familjeve të tyre.

Prandaj, kërkoj nga kolegët e mi deputetë të të gjitha partive dhe subjekteve politike që të veprojnë me arsye të shëndoshë dhe t'i kenë parasysh peripecitë, maltretimet dhe vështirësitë e punëtorëve të Kosovës, në përgjithësi, dhe të atyre të Fabrikës së Tubave të Çelikut, së bashkë me familjarët e tyre, në veçanti, dhe të votojnë për rekomandimin e propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me të cilin kërkohet prej Qeveria dhe Agjencia Kosovare të Privatizimit që të marrin masa për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e që praktikisht do të thotë kompensimi i pagave të punëtorëve të kësaj fabrike. Faleminderit!

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Privatizimi i Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj në vitin 2007 la pa punë më shumë se 900 punëtorë.

Fabrikën e ka blerë për 3 milionë e 657 mijë euro një punëtor i thjeshtë, i cili deri në atë moment posedonte vetëm një banesë dydhomëshe. Ndërsa në të ka investuar rreth 13 milionë e 200 mijë euro.

Punëtorët e Fabrikës në kohën e privatizimit kanë shprehur dyshime se pas blerësit, deri atëherë një punëtor, i thjeshtë qëndron politika dhe biznesmenët e fuqishëm.

Shumë prej ish punëtorëve që dikur merrnin paga deri në 1000 marka gjermane, sot jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike. Disa prej tyre i kemi parë edhe nëpër emisione televizive, që jetojnë në varfëri ekstreme.

Në vitin 2000, punëtorët e kësaj fabrike, të cilët ishin larguar me dhunë nga puna gjatë regjimit serb për periudhën '89-'99, e kanë paditur Fabrikën në Gjykatën Komunale në Ferizaj për t'i kërkuar të drejtat e tyre. Gjykata kishte vendosur që atyre t'u jepej kompensimi për 10 vjet, sa nuk kishin marrë paga.

Në aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Komunale në Ferizaj, të vitit 2002, thuhet se ajo ka vendosur për kompensim dëmi në vlerë prej 25 milionë euro për 912 punëtorët e larguar dhunshëm prej vitit 1990 deri në 2001. Ky aktgjykim u konfirmua më pas edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Me këtë, vendimi final dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhej të ekzekutohej nga autoritetet kompetente, Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, pasardhëse ligjore e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Ne e dimë se Gjykata Komunale është e pafuqishme të ekzekutojë vendim për dhënien e kompensimit të punëtorëve, por përgjegjësinë për ekzekutimin e këtij aktgjykimi e ka Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Tregimi për privatizimin në Kosovë është tregim i dhimbshëm, proces i korruptuar, transformim prone i dështuar, por për këtë nuk do të flas më shumë, sepse duket sikur po luajmë me ndjenjat e mijëra familjeve kosovare, e veçanërisht të 900 familjeve të punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj.

Unë këtu patjetër duhet të ngre edhe njëherë çështjen që ky debat nuk duhet assesi të cilësohet si ndërhyrje në Gjyqësor. Ata që e cilësojnë të tillë nuk kanë qëllim tjetër, veçse duan t'ia ndërrojnë kahun këtij debati.

Ndërhyrje në Gjyqësor mund të cilësohen iniciativat e Kuvendit për përkrahje të atyre që nuk pajtohen me vendimet e gjykatave, e tendencat e tilla nuk kanë munguar.

Ne si LDK jemi parti institucionaliste. Ne i përkrahim gjykatat, i përkrahim vendimet e gjykatave dhe si të tillë ne e përkrahim edhe vendimin për të cilin po flasim. Andaj, kërkojmë nga Qeveria dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që një vendim i tillë të ekzekutohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që ne të gjithë e përkrahim këtë debat dhe këtë rezolutë më në fund. Por, unë do të përpiqem që t'i them disa çështje më konceptuale në kuptimin që me atë çfarë po merremi sot, mund të lexohet edhe si debat për pasojën e pasojës të pasojës. Pra, shkaqet janë shumë më të thella dhe më të hershme, e besa edhe shumë të organizuara, për bindjen time.

Ekonomia e pasluftës në Kosovë e ka prodhuar të drejtën, e cila është bërë brutalisht pronësore dhe posesive. E drejta është e drejta për të pasur, jo aq për të qenë, e drejtë për të poseduar, jo për të përdorur a shfrytëzuar. Për shembull, nuk ka të drejtë për strehim a banim, por vetëm fakt të kryer të pasjes së banesës ose shtëpisë. Me këtë logjikë, edhe është zbatuar privatizimi në Kosovë.

Ndërmarrjet janë shituar si objekte, si asete të vdekura, e jo si kapacitete zhvillimore, jo si makineri prodhuese.

Te privatizimi në Kosovë ka ndodhur vrasja e ndërmarrjeve. Pra, mund të thuhet që ndërmarrjeve u është marrë shpirti, u është marrë prodhimi dhe janë shitur si kufoma, pra si objekte të vdekura.

Nëpërmjet privatizimit është fituar e drejta e disave për posedim dhe është humbur e drejta e shumicës për zhvillim, sepse paraprakisht është humbur mundësia për zhvillim.

Privatizuesit, pra poseduesit e rinj, kanë orientime, prioritete të tjera, e jo zhvillimin e vendit tonë.

Kosova dihet që nuk është mjedis i favorshëm për prodhimin vendës. Prandaj, edhe sot në Fabrikën e Tubave të Çelikut në Ferizaj të privatizuar ka fare pak prodhim. Janë vetëm 70 deri 80 punëtorë, të cilët punojnë 2-3 ditë në javë, me nga 4-6 orë pune në ditë. Bile numri i punëtorëve në mirëmbajtje është i krahasueshëm me atë në prodhim.

Shembuj të këtillë ka gjithandej nëpër Kosovë, sepse privatizimi e ka pasur për pasojë deindustrializimin dhe paralelisht me deindustrializimin erdhi kjo doktrina neoliberale, e cila na tha që duhet të fokusohemi në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Me ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ajo çfarë ndodhi është që fituam shumë ndërmarrje të vogla, gjithnjë më të vogla, derisa bankrotuan dhe fare pak të mesme. U shkatërruan sindikatat, u copëtua korpusi i punëtorëve. Ndërkohë që vendet e zhvilluara bëjnë diçka krejtësisht tjetër, ta zëmë edhe sipas një reviste liberale, si puna e 'The Economist' në Gjermani, prej ndërmarrjeve prodhuese atje, 55% i kanë më shumë se 250 punëtorë. Në Portugali, 19% të ndërmarrjeve prodhuese i kanë më shumë se 205 punëtorë, e në Kosovë është 0,8%, sipas raportit të UNDP-së. 80% të ndërmarrjeve në Kosovë e kanë veç një të punësuar. Ai është edhe menaxher, edhe pronar, edhe pastrues, edhe rojë, edhe kontabilist. Dhe 96% e ndërmarrjeve në Kosovë, prej gjithsej 56 mijë, sa më duket se janë, e kanë numrin njëshifror të punësuar. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si doktrinë kanë ardhur që ne të krijojmë ndërmarrje të vogla, që kanë qenë interesant në fillim, se prej asgjësë krijohet diçka. Mirëpo, ndërmarrja e vogël, po nuk u rrit, ajo nuk mbijeton. Prandaj, te ndërmarrjet nuk është shumë e rëndësishme nëse është e vogël, e mesme apo e madhe, sa është me rëndësi a po rritet a s'po rritet, e në Kosovë dihet se çfarë ka ndodhur me ato ndërmarrje.

Prandaj, Kosova, praktikisht, me këtë doktrinë ka përfunduar pa prodhim industrial. Buxheti i varfër i Kosovës varet prej importit që po na vret. Do të mund të thoshim që shteti i Kosovës në rrafshin ekonomik është shteti i droguar, sepse i nevojitet dëshpërueshëm ajo që po e vret, tamam sikur njeriut të varur nga droga i nevojitet dëshpërueshëm droga, por ajo e çon në vdekje. Ashtu edhe shtetit të Kosovës i nevojitet në aspektin ekonomik dëshpërueshëm importi, ndërkohë që importi po na vret.

Meqë kemi mbetur pa prodhim, dihet se krejt çfarë bëjmë është të importojmë. Kjo nuk është kurrfarë fatkeqësie natyrore, por pasojë e politikave qeveritare të pasluftës, ose e mungesës së tyre.

Ndërkohë, mu ata qeveritarë që na lanë pa prodhim, na rrëfejnë qysh i kemi SHBA-të dhe shtetet e BE-së partnerë. Partneriteti është partneritet ekonomik. Nëse i shikon shkëmbimet tregtare, ne si Kosovë e kemi shumë më tepër partner Serbinë, sesa cilindo vend të Bashkimit Evropian dhe shumë më tepër se Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Me këtë rast, do të kisha dashur që në origjinën e instalimit të doktrinës neoliberale t'i identifikoj dy dukuri.

Së pari, në emër të mohimit të socializmit janë mohuar edhe të gjitha variante tjera brenda kapitalizmit, përveç atij neoliberal. Pra, është thënë ‘po e mohojmë socializmin, por brenda kapitalizmit sërish është vazhduar mohimi, duke mohuar çfarëdo lloji tjetër të kapitalizmit, përveç atij neoliberal.

Dhe, në anën tjetër të së njëjtës dukuri, në emër të lirisë së zgjedhjes, kemi kufizim të zgjedhjes të produktet finale të kapitalizmit. Zgjedhim mallrat e fundit që i konsumojmë, por jo edhe zgjedhje të llojit kapitalizmit. Asnjëherë në Kosovë nuk është lejuar debati çfarë lloj kapitalizmi duam ne. Mirë, po kalojmë prej socializmit në kapitalizëm, por kapitalizmi ka shumë nuanca e lloje të ndryshme. Ka kapitalizëm japonez, amerikan, skandinav, të Evropës kontinentale, gjermane-francez, e mandej varet çfarë kapitalizmi në cilën epokë. Ky debat nuk është lejuar asnjëherë në Kosovë.

Dhe, dukuria e dytë në emër të tranzicionit nga socializmi në kapitalizëm e kanë privatizuar pronën shoqërore, mirëpo nuk janë ndalur aty. Kanë vazhduar edhe me privatizimin e pronës publike.

Domethënë, të gjitha këto janë elemente që po na sjellin në këtë situatë, ku ne diskutojmë për njërën prej fabrikave të shumta që e ka pësuar deindustrializimin.

Një ndër mitet kryesore të neoliberalizmit, siç shpjegohet nga modeli i shtetit zhvillimor në cilën bazohet, ta zëmë alternativa qeverisëse e Lëvizjes “Vetëvendosje”, është që për ndërmarrjet më mirë përkujdeset privati, dhe ai është më shumë i lidhur me to. Në fakt, nuk është kështu fare. Punëtorët janë shumë më besnikë ndaj ndërmarrjes. Punëtorët janë më besnikë, sepse ata e duan ndërmarrjen dhe janë jetësisht të lidhur me të, duke qenë se punëtorët me shumë vështirësi e ndërrojnë vendin e punës. Me shumë probleme mund të kalojnë nga një ndërmarrje te tjetra, sepse duhet ta ndërrojnë vendbanimin, zakonisht të punojnë për pagë më të ulët, po ashtu edhe anëtarët e tjerë të familjes duhet ta ndërrojnë vendin e punës. Edhe ata zakonisht pranojnë të punojnë për pagë më të ulët, fëmijët e të rinjtë në familje duhet ta ndërrojnë vendin e shkollimit dhe që të gjithë i humbin miqtë e vjetër prej lagjes së dikurshme, e tjera e tjera. Në ndërkohë që pronari e përjeton ndërmarrjen si shifër fleksibile në bursë. Kollaj e shet kur merr çmim të volitshëm.

Pra, një ndër mitet e mëdha është që privati është i lidhur me ndërmarrjen, e punëtori nuk është i lidhur, sepse e konsideron të të gjithëve. Është saktësisht e kundërta. Përvoja e vendeve të zhvilluara na e ka dëshmuar këtë gjë. Pikërisht pronari nuk është i lidhur me ndërmarrjen, se e sheh si shifër në bursë dhe porsa i ngrihen aksionet në nivel të profitit për të, ai e shet atë.

Por, të kthehemi edhe një herë tek Fabrika e Gypave të Çelikut në Ferizaj, ku të gjithë e dimë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, që është tema kryesore sot, i është dorëzuar edhe Qeverisë, edhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për borxhin që kjo ndërmarrje ua ka punëtorëve. Gjykata Komunale e Ferizajt, në vitin 2002, e ka vlerësuar të jetë 25 milionë euro dhe këtë e ka mbështetur Gjykata Kushtetuese më 17 dhjetor të vitit 2010 si gjykim të drejtë dhe ka kërkuar që ky vendim i gjykatës të përmbahet.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk është përfillur asnjëherë, e as nuk është zbatuar, as nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, e as nga Qeveria e Kosovës. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese që i leverdisin regjimit të zbatohen, ato që nuk i leverdisin nuk zbatohen. Vazhdimisht thuhet se Gjykata Kushtetuese është organi më i lartë juridik në vend dhe se vendimet e saj janë të paimpikteshme. Ndërkohë që tash realisht po na del se në Kosovë ekziston një instancë më e lartë se Gjykata Kushtetuese për shkak se vendimet e saj nuk po përmbahen, pra qenka një instancë tjetër - Qeveria apo AKP-ja dhe ata e paskan të drejtën e interpretimit të vendimeve të Gjykatës pikërisht për shkak se ato janë suspenduar së zbatuari.

Mendoj që e kemi të gjithë të qartë se punëtorët në Fabrikën e Tubave të Çelikut po e duan ndërmarrjen më shumë se sa pronarin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Petar Miletiq.)*

KRYESUESI: Jo! Jedan minut poslaniku Kurtiju.

ALBIN KURTI: ...dhe kjo është dëshmuar edhe me rastin e punëtorëve, të cilët kanë bërë disa protesta, me ç'rast në shumë prej tyre u është dërguar policia, dhe me ç'rast një herë janë nxjerrë me dhunë nga fabrika e tyre pa folur fare për borxhin ndaj punëtorëve. Pra, e kemi të drejtën e disa pronarëve që e blejnë për 3 milionë dhe të drejtën e qindra punëtorëve që ua ka borxh tash Fabrika 25 milionë. E drejta e parë është realizuar, kurse e drejta e dytë e pamundësuar. Qeveritarët që po na thonë se ku të merren tash 25 milionë, pyetjes së tyre duhet t'u përgjigjemi me një pyetje, para së gjithash: Pse e keni shitur për 3 milionë? Mendoj se përfundimisht rasti i Fabrikës së Tubave të Çelikut më së miri i dëshmon dy gjëra: e para se privatizimi si konstante ekonomike dhe aspak ekonomike, në një kuptim tjetër, jo vetëm që i ka inkurajuar të drejtat e shoqërisë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e di që është bërë debat i mjaftueshëm për ta vërtetuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe që duhet të zbatohet, pavarësisht ndaj kujt është orientuar. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka arritur të shkarkojë president të këtij vendi dhe është përfillur vendimi i saj, ka arritur që t'ua heqë imunitetin deputetëve dhe është pranuar si një vendim i cili është legjitim. Ka pranuar po ashtu deputeti i Parlamentit të Republikës së Kosovës që në tërheqjen e Ligjit për deputetë ta sjellë në rishqyrtim përsëri Projektligjin, ndërsa një vendim që bazohet në të drejtën e gjykatave të mëhershme, të cilat kanë marrë vendime që bazohet në një vendim, i cili duhet të zbatohet, ka këtu një super-agjenci a super-qeveri, e cila nuk i obligohet krijuesit të vetë atij organi - që është

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Duhet ta kuptojmë përfundimisht se këtu kemi institucione, të cilat nuk i përfillin vendimet, nuk i përfillin gjykatat, nuk i përfillin ligjet, e janë të thirrura pikërisht që t'i zbatojnë ato. Prandaj, obligim i Kuvendit është që ta gjejë mënyrën e duhur për të ndërmarrë masa andaj këtyre mekanizmave, të cilët nuk i zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Po e them edhe një herë, përfundimisht. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet të zbatohet dhe Kuvendi si organi më i lartë i vendit e ka për detyrë të marrë masa ndaj agjencisë, të cilën e ka krijuar dhe ndaj Qeverisë, të cilën e kanë nxjerrë në këtë Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Këtu janë dy çështje kryesore në diskutim: koncepti i ekonomisë, i cili është ndërtuar në Kosovë dhe mundësia e zhvillimit ekonomik nëpërmjet privatizimit, dhe ligjshmëria e vendimmarrjes dhe zbatueshmëria e tyre. Sa i përket ligjshmërisë së vendimmarrjes, sot ky Kuvend e dha shembullin më të keq me vendimin për Bordin e AKP-së dhe ky shembull i keq do të ndikojë negativisht po ashtu në ekonomi. Ekonomia, e cila është ndërtuar në këtë vend, është një ekonomi që nuk po funksionon dhe kryesisht këto vendime për mosfunksionimin e kësaj ekonomie janë marrë nga ndërmarrja, nga Agjencia e Kosovës për Privatizim, më herët Agjencia e Mirëbesimit e Kosovës.

U tha që ne nuk mund të diskutojmë vendime gjyqësore dhe vendimet gjyqësore nëse diskutohen në tribuna politike, politizohen. Parimisht do të ishte kështu, mirëpo ne e kemi problem thelbësor dhe ky problem yni thelbësor është respektimi i vendimeve gjyqësore. Çfarë lloj gjyqësie kemi ndërtuar ne? A po funksionon ky sistem gjyqësor dhe a po realizohen vendimet, të cilat merren nga sistemi i gjyqësisë dhe me këto probleme realisht po përballet sot shoqëria e Kosovës dhe kjo përballje sot ka ardhur në Kuvend dhe ne sot po diskutojmë për këtë shqetësim. Këtë shqetësim po e diskutojmë dhe po e adresojmë, sepse është krijuar një praktikë, ku është vendosur në nivel të Gjykatës Komunale të deritanishme, tashmë Gjykata e Faktit, është vendosur në Gjykatën e Qarkut, që tash njihet si Gjykatë e Apelit, është vendosur në Gjykatën Supreme dhe ka shkuar deri edhe në Gjykatën Kushtetuese. Vendim pas vendimi, vendim i formës së prerë dhe vendim i cili është gjykuar në Gjykatën Kushtetuese dhe nuk po jepen pasojat. Pasojat juridike nuk po zbatohen dhe ne si shoqëri duhet të bisedojmë, duhet të diskutojmë se çka po ndodh me këtë vend.

Kur ndodh në një ndërmarrje, e cila i ka 900 punëtorë, 900 familje, që prodhon pasojë juridike, ku ka vendim të Gjykatës Kushtetuese, i cili nuk zbatohet, çka ndodh me vendimet tjera? Çka ndodh me vendimet të cilat merren për një individ, vendimet të cilat mund t'i cenojnë të drejtat dhe interesat e individit? Çka ndodh me këtë sistem? Ky sistem realisht është jofunksional, ky sistem është një sistem i keq, sepse qytetarët e Kosovës nuk po i mbron. A e kemi ndërtuar ne sistemin 'check the balance'? A po kontrollohet dhe balancohet sistemi nëpërmjet Gjykatës Kushtetuese. Realisht, Gjykata Kushtetuese e jep një vendim të mirë, por jep edhe vendime të këqija. Ne e kemi një vendim tjetër të Gjykatës Kushtetuese që merret me po ashtu me Ferizajn, kur merr një

vendim që lirohet që të kthehet në rigjykim një çështje, kur realisht Gjykata Kushtetuese nuk është dashur të merret me këtë punë.

Gjykata Kushtetuese nuk merret me administrimin e pronës. Me administrimin e provave nuk merret as gjykata, tashmë Gjykata e Apelit. Gjykata e Faktit merret me administrimin e fakteve dhe provave. Gjykata e Apelit merret me procedurën e administrimit të fakteve dhe provave. Gjykata Supreme merret me ligjshmërinë e vendimit për këto fakte dhe prova dhe aty çështja mbyllet. Nëse shkon në Gjykatën Kushtetuese, shkon kushtetutshmëria e ligjit mbi të cilin është marrë vendimi dhe jo vendimi konkret, dhe i kemi me qindra raste që janë marrë vendime dhe sistemi është tollovitur. Çka duhet bërë ne si shoqëri? Të diskutojmë, apo të mos diskutojmë, se këtu u tha se ne nuk duhet t'i diskutojmë vendimet e gjykatave. Unë mendoj se ne duhet të diskutojmë dhe duhet t'i shohim me shqetësim këto vendime dhe duhet t'i shohim me shqetësim se si po mbrohet jeta, interesi, aktiviteti, produktiviteti i qytetarëve tanë, sepse vendimet e gjykatave herë zbatohen, e herë nuk zbatohen. Vendimet e gjykatave të njerëzve të fuqishëm me pushtet zbatohen, ndërsa të njerëzve të pafuqishëm dhe që nuk i përkrah pushteti nuk zbatohen.

Këtu kemi shembuj, kemi raste konkrete që janë të dhimbshme për qytetarët e Kosovës dhe janë të dhimbshme për ndërtimin e shtetit juridik dhe shtetit të së drejtës. Ku shkojmë ne me këtë lloj shteti? A mund të shkojmë ne me këtë lloj shteti drejt integriteteve evropiane? Unë jam i bindur që nuk mundemi të shkojmë. Nuk mund të shkojmë me këtë lloj shteti drejt integriteteve evropiane, meqë nuk respektohen vendimet e gjykatave, ku gjykatat merren me çfarëdo lloj rasti, ku nuk ka një hierarki gjyqësore dhe ku nuk ka një hierarki vendimmarrëse, ku Ekzekutivi i vendit nuk i respekton vendimet e gjykatave! Kemi plot vendime të gjykatave që nuk janë respektuar. E kemi vendimin për Këshillin e emërimeve të larta, i cili ka kthyer me dhjetëra njerëz në punë, dhe me vendime administrative politike njerëzit janë larguar prej pune dhe nuk kthehen. As nuk kompensohen! Ky është një sistem i keq dhe kjo qeverisje e ka kapur sistemin dhe ky është problemi kryesor dhe ky shembulli i kapjes së sistemit u vërtetua edhe sot me anëtarin ekzekutiv të Bankës Qendrore dhe me Bordin e AKP-së, i cili na e ka prodhuar këtë problem sot, i cili është dashur normalisht t'ua kthejë paratë, siç po thotë zoti Hamiti, që ka të drejtë, që është dashur t'ua kthejë paratë punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut, por realisht kjo po prodhon pasoja negative dhe po e rrezikon qëndrueshmërinë ekonomike, dhe realisht po e rrezikon edhe qëndrueshmërinë ligjore.

Ne e kemi bërë si modë se nuk u besojmë njerëzve tanë që flasin dhe kemi dëshirë t'u referohemi praktikave dhe vlerësimeve të raporteve ndërkombëtare. Fatkeqësisht, raportet ndërkombëtare po e konfirmojnë që ne qëndrojmë keq edhe në aspektin e ekonomisë, edhe në aspektin e administratës, edhe në aspektin e sundimit të rendit dhe të ligjit, edhe në aspektin e gjyqësisë, edhe në aspektin e jetës së përgjithshme të qytetarëve të Kosovës. Kjo është e keqja e përbashkët, të cilën ne duhet ta luftojmë dhe kjo qeverisje nuk është në gjendje ta përmirësojë jetën e këtyre qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ali Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: I nderuar nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

E kam një shqetësim në rrethanat në të cilat po e diskutojmë një problem shumë të mprehtë. Po vërej se pikë së pari kjo temë është tepër e nxehtë për t'u trajtuar në këto kohë kur deputetët janë të lodhur, pastaj prapa po vërej se nuk është asnjë anëtar i Qeverisë, po vërej se edhe kuorum nuk e di a do të ketë, por unë mendoj se ky problem e do një trajtim të mirëfilltë prej gjenezës e deri tash.

Këtë problem, unë do ta kisha ndarë në tri faza, në tri kohë, ku lidhen edhe tri lloj përgjegjësisë. Përgjegjësia e parë ka qenë para lufte, mendoj në vitet '89 apo '90. Nuk e di në cilën kohë i kanë larguar, por ka qenë eksperimenti i parë i Serbisë kur e bëri spastrimin e punëtorëve shqiptarë nga institucionet. Pra, Fabrika e Gypave të Çelikut ka qenë eksperiment i parë që e ka zbatuar Qeveria e Milosheviqit në Kosovë dhe kujtoj se proceset e ankimimit për t'i kërkuar të drejtat e këtyre punëtorëve datojnë qysh nga ajo kohë, meqë vërtet deri në momentin e largimit të tyre ka qenë një prej fabrikave më fitimprurëse për Kosovën.

Të jua përkujtoj që në atë kohë kanë pasur eksport mbi 30 milionë dollarë. Unë mendoj se në këtë kohë Qeveria, për këtë dhe për shumë tjera tema, siç është fondi i pensionistëve; kursimet e qytetarëve e shumëçka tjetër, është dashur ta ketë një material të përgatitur dhe ta prezantojë një prej kërkesave thelbësore që Kosova sot po debaton me Serbinë. Ka edhe shumë tjera, por unë i përmenda dy apo tri që janë humanitare, që nuk mund asnjë institucion ndërkombëtar, e as një individ që ta mohojë të drejtën e kërimit të tyre. A e ka bërë Kosova këtë? Nuk e ka bërë.

Faza e dytë është formimi i AKM-së me Rregullore të UNMIK-ut dhe qeverisje të UNMIK-ut. Po i cek këtu, sepse moti, brenda një jave e dëgjova njërin nga ministrat aktual kur tha se përpara në borde ka pasur edhe ministra. Ka pasur ministra, por nuk ka qeverisur Kuvendi. Legjislativ nuk ka qenë Kuvendi deri në shpalljen e pavarësisë. Ka qenë PSSP-ja dhe i kemi pasur rregulloret, në bazë të të cilave është vepruar. Bile në Rregulloren e AKM-së ka qenë decidivisht se cilët ministra, të cilës ministri duhet të jenë dhe llogari i kanë dhënë PSSP-së, e jo Kuvendit. Prandaj, periudha e tretë dhe e fundit është pas shpalljes së pavarësisë, do të thotë pas marrjes së funksionit të Legjislativit nga Kuvendi. Kuvendi e ka themeluar Bordin e AKP-së thash, jo PSSP-ja, dhe nëse e ka krijuar një organ, ai me të drejtë i kërkon llogarinë dhe nga ajo e drejtë AKM-ja ia prezanton Kuvendit raportin vjetor të punës së vet, sikur që e ka formuar Qeverinë dhe i kërkon raport edhe asaj.

Unë nuk shoh arsye të dyshojmë se mos po interferojmë ne në përzjerje të kompetencave. Jo, zotërinj! Ne po e kryejmë një detyrë, bile mendoj shumë vonë, por më mirë vonë se kurrë. Kuvendi do të duhej të kërkonte përgjegjësi nga këto dy institucione. Fillimisht për të drejtën pse ka ardhur deri në këtë kohë dhe e dyta të kërkojë përgjegjësi për mosrespektimin e dispozitave ligjore në veprim. Ku e kam fjalën? Sepse me gjithë vërejtjet që i jep gjykata dhe institucionet gjyqësore që ta ndalë procesin e privatizimit, te kjo ndërmarrje ndodh procesi i privatizimit. Kjo është në kundërshtim me të gjitha dispozitat ligjore, sepse ka qenë në proces të kontestimit, në proces të kërimit të drejtës nga punëtorët dhe t'u dalë në ndihmë Gjykata e Strasburgut, e Kuvendi ynë të heshtë për

këtë çështje, unë mendoj se jemi të vonuar, por e kemi për detyrë të shenjtë që në konkluzione, që unë nuk i di çfarë janë, do të doja që të afatizohet në një periudhë - një muaj, dy muaj, tre muaj. Të urdhërohet Bordi i AKP-së që t'i zbatojë të gjitha vendimet, që fatmirësisht i përkrah dhe i ka mbështetur në të gjitha instancat juridike. Prandaj, nuk ka hezitim se mos po interferojmë. Ajo është vetëm mjegull për ta zvarritur problemin, për ta mbajtur njëfarë shprese se, 'ja edhe unë jam, por në këtë formë'. Ju lutem, mjegull shumë është hedhur këtu. Në këtë nivel, në këtë proces, në këtë rast, dhe unë mendoj që është koha e fundit që të jemi të qartë para njerëzve dhe t'i mbrojmë ose t'u japim mbështetje në të drejtën e tyre shumë legjitime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Mendoj që diskutimet janë shteruar, përveç përfundimit që do ta japë zoti Beqiri. Desha ta shtoj vetëm një çështje. Në çdo vend të Evropës, ku ka konteste, përmbartimi i ekzekuton vendimet e gjykatës, e në asnjë vend të Evropës nuk i ekzekuton Parlamenti. Ky është rregull që funksionon gjithkund në botë dhe po më dhimbet edhe vetja, ju të gjithë, edhe Parlamenti, që duhet të merremi me problemet të cilave pikën duhet t'ua vënë gjykatat dhe përmbartimi. Faleminderit!

Zoti Beqiri e ka fjalën përfundimtare, meqenëse nuk është askush nga Qeveria.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues,

Unë së pari do të doja të ju them se siç po shihet, nuk ka kuorum. Pra, nuk ka kuorum se në fund duhet ta miratojmë një rekomandim, të cilin ne e kemi menduar. Prandaj, është mirë të konstatohet nëse ka kuorum.

KRYESUESI: Mirë, ti lexoji rekomandimet, e nëse nuk ka kuorum e votojmë në seancën e ardhshme, e lëmë vetëm votimin.

ISMET BEQIRI: Mirë, të shohim nëse kemi kuorum, por nëse nuk kemi, zoti nënkryetar...

KRYESUESI: Në sallë janë të pranishëm 61 deputetë.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar, atëherë po e propozoj këtë konkluzion të vetmin, ose këtë rekomandim, duke mos e përsëritur arsyen. Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, por edhe nga diskutimi, të propozoj që rekomandimi të jetë ky:

Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe organet tjera kompetente ta bëjnë ekzekutimin në afat katërmujor të aktgjykimeve të gjykatave kompetente për pagat e papaguara të punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj.

Pra, ky është propozimi i këtij rekomandimi dhe kërkoj të hidhet në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bajrami, i kemi shteruar diskutimet.

(Ndërhyrje)

Jo, jo! Ne mund të votojmë, apo të mos votojmë. Ju keni mundur t'i kërkonti më herët. Ismeti është dashur që konkluzionet t'i lexojë më herët dhe t'i harmonizoni ju ndërmjet veti. Megjithatë, ky e tha fjalën e tij lidhur me këtë dhe ne tash e kemi radhën t'i votojmë, prandaj i hedh në votim. Kuorum kemi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

*(Ndërhyrje)*

Shiko! Unë e kam pasur një reagim njëherë me zotin Beqiri, e mendoj se edhe ky ka pasur të drejtë ta kërkojë, por unë, meqë kam qenë kryesues i seancës, kam kërkuar që të nisin procedurat e rregullta dhe i ka ndjekur shumë mirë dhe ato i kanë sjellë në debat.

Ne e kemi kaluar kërkesën për debat në Kryesi, ku kanë qenë edhe kryetarët e grupeve parlamentare, dhe nuk ka qenë askush kundër.

Tani, e kemi përfunduar debatin dhe nuk e kam ndërmend ta fus çështjen përsëri në debat.

*(Reagime)*

Megjithatë, nëse zoti Beqiri është dakord t'ua japë për 2 minuta fjalën, urdhëroni.

Në rregull! Atëherë do të procedoj sipas Rregullores. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim lidhur me rekomandimet e zotit Beqiri. Në sallë janë 63 deputetë. Votojmë tash!

Atëherë, kush është për, e kush është kundër?

Janë 34 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim dhe sipas kësaj miratohet rekomandimi i zotit Beqiri dhe i grupit të deputetëve nënshkrues të debatit.

Faleminderit dhe mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:*

*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*